

EQREM ÇABEJ

STUDIME RRETH ETIMOLOGJISË SË GJUHËS SHQIPE XIX

Rr.

rrëshirë rrëshinë f. «lëndë ngjitëse që kullon prej disa drurësh halorë». Nga lat. *resina*, e cila rron ndër të tjera dhe në rumanishten (*răsină*), Miklosich AF II 701, G. Meyer 369, Pușcariu EW 1443, Weigand 75, Tagliavini 236v., Alessio Ann. d. Fac. di Lettere e Filos. Bari I 40. Për arom. *arușinë* sh. Papahagi 158.

E mbarë gjuhës. Del që te Budi SC 207. Mbiemri *i rrëshirtë, i rrëshintë*; neologjizëm *rrëshinór, -e*. Trajta *shindër* e geg. veriore, shënuar sëpari te Bashkimi, ka dalë me rrugë të një etimologjie popullore: duke u marrë *rrëshinë* në ndjenjën gjuhësore si *rrë-shinë* me prefiks *rrë-*, u thjeshtua në *shinë*, e kjo u zhvillua në *shindërr* (shkruar te Bashkimi *shinnerr*), duke u pajisur dhe me sufiksin *-ërr*, e fonetikiht në trup fjale me një *-d-* si tingull homorganik pas *n-së*. Geg. *shinë* i përgjigjet prej toskërishtes *shirë* f. «gomme des arbres» që jep Dozoni.

rrëvitem «hidhem; kam lidhje, drejtohem». Këtë fjalë të dialektit të Greqisë, që e ka Kullurioti, G. Meyeri 374 e lë të paspieguar. Bariçi (I 89) e merr për fjalë vendi të shqipes, duke e krahasuar me sllav. e vj. kishtare *vresti* e gjerm. *werfe* «hedh».

Fjalë dialektore, relativisht e re; identike me *vërvit* «hedh me fuqi», *vërvitem* «lëshohem me turr, me fuqi, vërsulem», që vjen prej sllavishtes. Kjo në ndjenjën gjuhësore të shqipes së Greqisë u muar sikur t'ishte *vër-vitem*, mbase edhe nën ndikim të *vërsulem: sulem*, dhe silaba e parë «u zëvendësua» kështu me prefiksin (*r*)*rë-*. Sh. dhe Bul. për Shk. Shoq. 4 (1956) 93.

rrfatë f.: sh. *furatë*.

rriell m.: sh. *rryell*.

rrjesht, rresht m. radhë», *rrjeshtëj rreshtëj* «vë në rrjesht». G. Meyeri (f. 374, AS IV 19) jep pas Kavaliotit fem. (*r*)*rrjeshtë*, pas Rossit mashk. *rrjesht*, pas Hahnit (si lokucion ndajfoljor) geg. *rrëjeshtë rrijeshhtë* «radhë-radhë, varg», pas Propagandës *rrisht* «verso», dhe anon ta spiegotë, sa për fonetikën, prej lat. *regestum regesta* «listë, katalog», nga e cila rrjedh lat. mesjetare *registrum* «regjistër». Këtë spiegotë, për arsye të kuptimit, e vë në dyshim Jokli (IF 36,147), dhe e bie fjalën të ardhur prej lat. *restis*, lat. vulgare akuz. *reste* «tërkuzë, litar», e cila në gjuhët romane ka dhënë gjithkund fjalë të kuptimit «varg me qepë», Meyer-Lübke EW 1725. Weigandi 75 e jep si *rresht* dhe e lë pa spiegotë etimologjik. Tani rishmë R. Bernard (Ling. balk. IX, 2, 1965, 86) fjalën e shqipes bashkë me bullg. *erišče* «lloj spageti» e nxjerr prej turq. *rište* «fill» *erište* «lloj spageti».

Del që te Budi (SC 67, 113, 116) me kuptim ndajfoljor, «varg»: *qi ndiekënë këtu rrjesht; qi janë këto rrjesht përfundit; qi vihenë këtu rrjesht*. Nga tri etimologjitë, vetëm ajo e Joklit mbetet e drejtë; ajo është bindëse si për nga forma si për nga kuptimi. Fjala në shqipen ka pësuar një zgjerim të kuptimit; nga emri i një varg qepësh, hudhrash etj. që do të ketë pasur në krye, mori atë të vargut a radhës përgjithësisht. Në parim është i mundur dhe një burim prej italishtes, si nga *resta di cipolle, di agli* «varg me qepë, me hudhra». Po prania e fjalës — mbi dëshminë e Kavaliotit — edhe në toskërishten, e kështu pra në mbarë shqipen, e bie më afër meç burimin latin. I padrejtë spjegimi i R. Bernardit nga turq. *rište erište*. Kjo (sh. G. Meyer 367) ka hyrë në shqipen si *rishte* «petëra», e cila si nga forma si nga kuptimi shihet se është një tjetër fjalë. Në atë drejtim dëshmon dhe çfaqja e fjalës që te Budi, me gjithë se te ky autor ka disa turqizma.

rrnok m. «ishull i vogël; stom që noton nëpër ujë». Këtë fjalë e jep Gazulli për Kelmend, Malsi të Madhe e anët e Mbishkodrës. Mbase është *ran-ok*, një rrjedhojë e *ranë-s* me *-ok* deminutiv.

rrobull m. «Pinus leucodermis, pishë mali, murë», edhe *rrobull i kuq; rrobull i bardhë* «Pinus peuce, molikë». Mungon te G. Meyeri. E ka me këto kuptime FG, Manni për një lloj dushku; Mitrushi 45 e 51 jep për Korçë *rrobull i bardhë* «Pinus excelsa, arnën», *rr. i kuq* «Pinus Heldreichi», në Tragjas të Vlorës *rrobull*. Sikundër e kemi shënuar shkurt në Rev. de Ling. VII 1 197, rrjedh prej lat. *robur* «Quercus ilex». Për këtë dru shqipja përdor më fort një tjetër fjalë latine, *ilq ilqe*, dhe *rrobull* ka kaluar te pishat, me gjithë se Manni, si u pa, e ka për një lloj dushku. Me fjalën e shqipes piqet në kuptim *arobul robul* «pesse; sorte de sapin, Abies alba, bredh i bardhë» e aromunishtes, të cilën Papahagi 149 (më parë në Etimologii 5) bashkë me gr. e re *ρόμπολο - ἡ ἀγρία πεύκη* mendon se vjen prej shqipes. Te Dimitrakos VIII 6429 *ρόμπολο* është «τό δένδρον πίτυς ἢ λευκή, pishë e bardhë». Në aromunishten e greq. e re fjala ka shkuar prej toskërishtes. Edhe me këtë huazim latin, i cili i mungon rumanishtes e dalmatishtes, shqipja piqet me gjuhët romane perëndimore, të cilat ndërkaq e ruajnë fjalën latine me kuptimin origjinal të ilqes, sh. Meyer-Lübke REW 7354.

rrodhe f. «emër bime, Arctium lappa». Spjegimin e G. Meyerit (f. 367) nga një lat. e rindërtuar **cardella*, prej *cardu(u)s* «gjëmbaç», me një zhvillim nëpër shkallët **kërdhelë: *grdhejë: *rdhë: rrudhé* (që ekziston): *rrodhe*, e kundërshton Pedersen (KZ 33,539) me të drejtë, meqë një ndrim *car: rru* nuk ka analogji në shqipen. Sikundër e shtjellon Jokli LKU 223vv., *rrodhe* është një fjalë vendi e shqipes, e afër me *rruaj*, dhe paraqet një emërtim të kësaj bime që gjindet kuptimisht në shumë gjuhë. Në lidhje me morfologjinë e *rrodhe-s* Jokli mendon si bazë të saj një indoeur. **rēd-*, *ku e-ja* e gjatë dha *o*, *d-ja* spirantin *dh*; dhe *-e-ja* fundore e sotmja ka dalë nga shumësi, duke e pasur marrë bima emrin e saj nga kokrrat gjëmbaçe që lëshon. Për mendimin tonë *rrodhe* është një formim i brendshëm i shqipes, një postverbal i *rruonj* (*rruaj rruej*) formuar nga një shkallë e lashtë e kësaj më *-o-*; *-dh-* më fort se refleksi i një *d-je* indoeuropiane do të jetë sufiksi *-dh -dhë*, diktuar prej Joklit vetë (Studien 30v., LKU 186v., 199, 207v., 300, Kretschmer-Festschrift 1926 f. 89. Mélanges Pedersen 142), formant i shpeshtë bash në emra bimësh e drurësh, si *shpardh shpardhë, vodhë vadhë*, sh. Khuvani-Çabej Prapashtesat 31. Mendimin e Joklit për burimin e *e-së* fundore prej shumësit, duke u paraqitur *rrodhe* kështu si një shumës i singularizuar, e kemi ndjekur dhe ne në Li. Po. VIII 91. Pa

përjashtuar këtë mundësi, tani mendojmë se kjo mund të jetë *-e-ja* e femërore, duke shkuar dhe ky emër pas prirjes së shqipes për të bërë femërore më *-e* ndër të tjera dhe mjaft emra bimësh, sh. poaty 170 v. Një shumës i singularizuar përkundrazi është *rrodhes* f., emri i kësaj bime në çamërishten, po që në thelb është emri i kokrrave të saj, të cilat quhen pikërisht *rrodhes-t* pl., sh. Li. Po. VIII 91. Trajta *rrudhë* me sufiks *-ë-*. Afrimin që bën Bariçi (I 92): *rodhe*: lit. *rëzgis* «shportë, kaçile e thurur» *rezgù* «thur, lidh» etj., e hedh poshtë me të drejtë Jokli në veprën e cituar, f. 327. — Sh. edhe *rrozgë*.

rrojbë, rrolbë f. «*Carthamus tinctorius*» (dhe *Rubia tinctorum*?). Emër bime, që s'e ka G. Meyeri. Bashkimi *rrolbë* «specie di erba le cui radici tingono in rosso», Gazulli për Mirditë *rolbë rrolbë* e *rrollbe* «*Carthamus tinctorius*, gjerm. Saflor; përdorej djerë tash vonë me nje». Në Kalush të Kavajës *rrojbëz*, në anët e Vlorës *rrolbzë* (Rr. Zojzi); me këtë mbase identike *rrojbëz* në Myzeqe «tangle, turisted knot», ER te Manni. Në Gjirokastër emër familjeje *Rojba*. Një trajtë me *-v-* jep Godini, *rrânzë rroive* «*Krapp-(wurzel)*». Nuk ka dyshim se burimi është lat. *rubia* «*Rubia tinctorum*», e cila gjer tani dihej vetëm për rumanishten (*roibă*), italishten (*robbia*), spanishten e katalonishten (*rubia*) dhe portugjishten (*ruiva*), sh. Meyer-Lübke REW 7409. Nga këto forma shihet pikësisht se prej dy varianteve kryesore të fjalës shqipe, *rrojbë* është primarja, *rrolbë* sekundare, formuar në analogji me dubletat më *-l-* e më *-j-*, si i *halthëm*: i *hajthëm*, i *kalthët*: i *kajthët* (sh. i *hajthëm*). Pastaj vihet re një afrim më i ngushtë midis trajtave të shqipes, rumanishtes e portugjishtes (*rrojbë, roibă* e *ruiva*) në punë të pozicionit të *-b-së* ndaj *-i-së*, përkundrajt it. *robbia* e span. *-kat. rubia*; në rumanishten mbizotëron ajo formë, me gjithë se nuk mungon *robia rodea* nëpër dialekte, sh. Tiktinin III 1332, 1335. Në punë të vokalit të brendshëm *-o-* shqipja ndërkaq piqet me rumanishten. Në disa të tjera rasa të këtij lloji, si *zmojle, Groftat e Gojanit, Shkortull, Maja Volpul* Jokli (BA IV 196vv., IJ XIV VII 145) sheh elemente të latinishtes së Prevalitanës, të afra me ato të dalmatishtes, e ne përkundrazi (Revue de Ling. VII I 164v.) gjejmë aty trajta të geg. lindore që arrijnë gjer në bregdet, duke përfshirë aty eventualisht dhe fjalën *troftë*. Kuptohet se në atë grup nuk mund të hyjë *rrojbë* me përhapjen e saj në mbarë gjuhën. E ndërlikuar paraqitet puna e vokalit të brendshëm dhe për fjalën rumune. Aty dialektet ndahen, në mënyrë që dakorumanishtja paraqet vetëm trajta më *-o-*, ashtu si shqipja, po aromunishtja ka vetëm *ruibu* «garance», te Papahagi 910; përkundrazi te një tjetër refleks i fjalës latine që ka rumanishtja, refleks i *rubeus* «i kuq» si emër kuajsh, në të gjitha dialektet rumune zotëron trajta më *-o-*: dakorum. *roib* «(kalë) i kullmë, kull» fem. *roaibă* «(pelë) kulle» arom. *aroibu* «cheval alezan», Pușcariu EW 1473, Papahagi 149. Në fjalën e shqipes e të rumanishtes e rregullt do të ishte trajta më *-u-*. Kundra përpjekjes së Schürrit (Cahiers S. Pușcariu I 86-90) për të spieguar *-o-në* e *roibă-s* shprehet Rosetti ILR I⁴ 76. Khs. edhe Rothe II. Një vemendje të veçantë meriton në këtë mes fakti i theksuar nga Grauri (Romania 55, 469vv) që te George 240v. për latinishten pranë *rubeum* dëshmohet edhe *robium*; sh. dhe Rosetti ILR I⁴ 76, Mihaescu Limba latină in provincile dunărene ale imperului roman 70v. Për mendimin tonë kjo mund të jetë gurra e përbashkët e shq. *rrojbë* e rum. *roibă*. Është vështirë të mendohet një trajtë me metatezë (diçka si **roibum*) për të spieguar reflekset shqiptare e rumune të fjalës latine. Metateza mund të jetë kryer më vonë në dy gjuhët ballkanike. Po khs. m'anë tjetër dhe port. *ruiva* përkundrajt span. *kat. rubia*.

rrozgë f. «vend me ferra, shkorret; lëmishte, kërcunj e cokla që sjell lumi; driza gardhesh». G. Meyeri 367 e jep pas Rossit me kuptimin e it. *tribolo*, të cilën e përkthen me «*Carduus nutans*», dhe e spiegon nga sllav. *rozga*, sllav. e vj. kishtare «degë, gem». serbokr. «kunj, shtagë; plish; furkë ardhish», pol. «thupër, purtekë» etj., po vë vërtet në pah largimin e kuptimeve. Pas Joklit LKU 220 e afër me *rrodhe*, si një zgjerim i kësaj me *-skë*, e *rrodhe* vetë e afër me *rruaj*. Te burimi sllav kthehet Barići I 92 e Se-lišcevi 189.

Fjalë kryesisht e gegërishtes dhe e tosk. veriore. Edhe Godini e ka për «*Burzeldorn, tribulus*». Në anët e Gramshit e në Irmaj të Sulovës shënon edhe drizat a degët me të cilat thurin gardhet, varret e rrugët e fshatit. Ka edhe rrjedhojat *rrózgulla* e *rrozhgina* fpl. «lëmishte; bazhgaret, bëzhdi-let që heqin me fshesë, të fshirat». Shumësi *rrozga* në kompozitin *rrozga-bjezga* «pa rregull, rrëmujë, pështjellas, trazuar» përdoret si ndajfolje, sh. Xhuvani-Çabej Prapashtesat 6. *Rozg* është një katund i Krujës, Gazetteer 145. — Sikundër del nga të dhënat dialektore, fjala ka një fushë kuptimore më të gjerë. Ndër kuptimet e saj del dhe ai i degës, i purtekës. Prandaj burimi është sllav. *rozga* «degë». — Me *rrozgë* është identik *rrozg*, fem. *rrozgë* «për një njeri a një shtazë shtëpiake të plakur, rrol», *plak rrozg*, *ka rrozg*, *rrozgë* «plakë e stërkequr», në Myzeqe edhe për lopë, buaca, pela, dele e dhi plaka (J. Llazari). Ky emërtim pejorativ i njeriut a shtazës së plakur ka dalë nga përdorimi i *rrozgë-s* për të shënuar lëmishtet a coklat e kalbura që sjell lumi me vete.

rruaj rruej. Mendimi i G. Meyerit (f. 375) që e shpie këtë fjalë te lat. *radere*, gjen pëlqim në një kohë më të parë, te Meyer-Lübke Gr Gr I² 1052 e te Pušcariu Ew 1422. Weigandi 76 e mendon të formuar nga një përzjerje e dy verbevet latine *rodere* e *radere*. Një hap më tej shkon Jokli LKU 223v., i cili mbi dëshminë e emrit *rrodhe* që ka lidhje me *rruaj*, gjen këtu një formim verbal më *-uaj* si *luaj* dhe me kaq një fjalë vendi të shqipes, e afër me fjalën latine, me gjerm. e lartë të vj. *rāzi* «e fortë në shije, e egër».

Fjalë e mbarë gjuhës. Buzuku (LXV/2 = LXXV/2, Apostujt 8,32; LXXXX = CX, Jobi 1,20) e porsit *qengji qi anshtë i pāgojë përpara atī qi e rruon* «et sicut agnus coram tondente se sine voce», e *rou kryetë e tī, e ɥ lëshuo për dhē* «et tonso capite corruens in terram», Bardhi *Radere Me e ruem*. Nga një përdorim drastik i kësaj fjale ka dalë geg. veriore *rruej* «ha»; khs. për këtë përdorim shprehje të tilla si *e fshiu gjellën, e për lau gjellën*. Për etimologjinë do thënë se nga trajta e fjalës nuk mund të thuhet me siguri a kemi të bëjmë me një fjalë vendi a me një huazim prej latinishtes; nga kjo anë *rruaj rruej* nuk do t'ish pa analogji në shqipen, khs. *truaj truej* nga lat. *tradere*. Ndërkaq prania e emrit *rrodhe* flet më fort në të mirë të një burimi të vendit. Kjo jo për arsye të formës, si mendon Jokli (sh. *rrodhe*), po për arsye të kuptimit: emri i bimës përmban idenë e të gërvishturit e të së kruarit; përkundrazi fjala latine, po të ketë hyrë me të vërtetë në shqipen, duhet të ketë depërtuar më fort si term teknik i të rruarit të kripit të kresë e të mjekrës. — Sh. edhe *rogë, rukë*.

rrush m. Fjalë me etimologji të diskutuar. G. Meyeri më parë (AS I 41) e krahasonte me ind. e vj. *rasā* «rrush» pers. *raz razan* kurd. *rez* «ardhi, rrush»; po më vonë (Fj. et. 371) mendon -me dyshime-për një afrim me sllav. e vj. *grozdъ* «rrush». Këtë e kundërshton Bernekeri I 355, po e pranon Oštiri Arhiv II 33vv.; khs. dhe Tagliavinin 214. Deržavini (Jazyk i litera-

tura I 191) bën një afrim me sllav. *rojno* «verë». Më parë Kamarda (I 87, 179) e bashkonte me gr. *ρῶξ ρωγός* «kokërr rrushi».

Fjalë e mbarë gjuhës. Shumë produktive në terminologjinë e florës popullore: *rrush i egër* e *rr. gardhi* «*Vitis silvestris*, larëz», *rr. mali* «*Vaccinium myrtillus*, boronicë», *rr. frengu* e *rr. toke* «*Ribes grossularia*», *rr. geni* (Luma) «*Sorbus aucuparia*», *rr. arushe* «*Arctostaphylax uva ursi*», *rr. fëllanxe* «*Daphne oleoides*», *rrush-qyqe* (Përmet) «bimë e vogël me kokrra të vogla e të kaltra si të rrushit», ER Ser. III viti I (VII) Nr. 12. f. 487. Në ishullin Poros të Greqisë *rush-kuq* «lulet e lajthatës, që varen si vile e këputen e hahen si rrushi (Reinhold, te G. Meyer AS V 100), te Heldreichu 73 *rush-kuqe* si këto si kokrrat e kuqe e të zezat të bimëve *Solanum nigrum*, *S. humile*, *S. villosum*, në ishullin Specia (f. 79) *rush-gjalpërit* «*Solanum nigrum*, *S. humile* etj». Te Mitrushit 421 dhe *rrushë* «*Cistus villosus*, mëniste», zgjerim me sufiks -*é*-. Del që te Buzuku (LXXV = LXXXV, Mateu 7,16; LXXVIII/2 = LXXXVIII/2, Amoni 9,13): *A mundë meretë n drizashit rush, o fiq n therëcashit?* «Numquid colligunt de spinis uvas aut de tribulis ficus?»; *Hinje se të vinjënë ditë qi të afëronetë bulku me korësit, e aj qi shtypën rushtë me atë qi mbiell* «Ecce dies veniunt: et comprehendet arator messorum, et calcator uvae mittentem semen». Bardhi *Uva Rush*, *Qualus Koshi i rushtet*, *Racemus Veshi i rrushit*. Bogdani (I 51, 14, II 22,6) e *Noeu gjet së riu si kish për t u nxjerrë vena n'rrushit* «e Noè v'aggiunse il modo di cavar vino dall' uve»; *lulëzuenë vëneshtënatë, e banë rush e u pojnë* «fiorirono le vigne, fecero uva, e si maturarono».

Si e kemi shtjelluar dhe te VII Congr. Internaz. di Scienze Onomastiche 1961 f. 247, BUST XVI 1 (1962) 223, *rrush rush*, si refleks i një baze **ragus-* ose **ragusj-*, afrohet me gr. *ρᾶξ ραγός, ρῶ ρωγός* «kokërr rrushi». Nga baza e fjalës shqipe e kanë emrin e tyre dhe qytetet *Ragusa* në Siqeli e *Ragusium* (Ragusa) në Dalmaci, të cilën do vënë re se Bogdani (II 20,6) e quan *Rushë*, e te «Pleqenia e shtepisë Bogdananjet» *Rush*. Te **ragus-*: *rrush* (e te *Ragusium*: *Rush*) shihen shenjat e zhvillimit fonetik të shqipes: hifereza e vokalit në silabë përpara theksit, zhdukja e *g*-së intervokaliqe, ndrimi i *s*-së në *sh*. Nga pikëpamja onomasiologjike *Ragusium* e *Ragusa* e Siqelisë janë emra visesh që burojnë prej emrash botanike, ashtu si *Dardania*: *Dardha*, si *Driza*, *Fier*, *Fikas Fishta*, *Mërqinja* etj. Gjuhësisht te gr. *ρᾶξ ρῶξ*: shq. *rrush* kemi një fjalë të shtresës jo-indoeuropiane në këto dy gjuhë, poashtu si te *σίδη*: *shegë*, *λαπάθη*: *lëpjetë*, *μαλάχη*: *mëllagë* etj. Për gr. *ρᾶξ* sh. tani dhe A. Carnoy, *Revue des Etudes Grecques* LXIX (1956) 271vv. Morfologjikisht fjala e shqipes qysh në bazën e saj **ragus-* ose **ragusj-* (khs. *Ragusium*) paraqitet si një deminutiv më -*ush*. Pra kuptimi i parë i saj është «kokërr rrushi». Kështu dhe lat. *baca* «kokërr» ka dhënë në ndonjë dialekt të gjuhëve romane «kokërr rrushi» (Meyer-Lübke REW 859); m'anë tjetër fjalës latine i përgjigjen prej keltishtes kymr. *bagwy*, korn. *bagas* etj. që janë emrat e rrushit (sh. Walde-Hofmann I 91). Kuptimi i parë i fjalës shqipe, «baca, kokërr», duket të ruhet dhe tek emrat botanike *rrush mali*, *rr. arushe*, *rr. fëllanxe* etj. që u dhanë më sipër. — Me këtë spjegim të *rrush*-it rehabilitohet gjer diku etimologjia e Kamardës. Te **ragus-*: *rrush*, mbi dëshminë e përhapjes gjeografike kemi të bëjmë pas gjase me një fjalë iliro-shqiptare.

rruvâ m. «veshi i rrushit pa kokrra, freri i rrushit, frenja». Fjalë e geg. veriore, mbetur pa spjegim te G. Meyeri 376 e te Weigandi 76. Meqë sipas Kristoforidhit në gegërishten ka edhe *rrufane* *rrufâ*, e sipas ER

1930 f. 209 në toskërishten *rrufá*, në Li. Po. VII 167 e lidhim këtë fjalë me geg. *rrëfanë* «vesh i enës, vegjë (vorbe, kazani etj.), bisht i një peme» e të dyja i bashkojmë, si trajta me prefiks (r) *rë-*, te fjala *va-u* me kuptimin e një sendi të lakuar, të kthyer.

rruví f. «vijë, vizë disi e thelluar që hiqet në gur, nënjë dërrasë etj.»; *rruvjeshkull* f. «*rruvi*, vijë, vizë». G. Meyeri 376 për *rruvjeshkull* mendon — me rezervë — një burim prej një lat. së rindërtuar **rubescula* prej *ruber* «i kuq», duke pasur parasysh vizat e kuqe. Si e kemi shtjelluar në Bul. për Shk. Shoq. 3 (1954) 60, Kristoforidhi 364 këtë fjalë të Elbasanit e lidh me *vi-a* «vijë», po në f. 22 *rruví*-në e afron me *vërrí-a* «(μικρόν) αύλα κίον, hulli e vogël». Kjo etimologji gjan të jetë e drejta: *vërrí* dha me meta-tezë *rrëví*, trajta që ndihet sot në Elbasan; kjo dha *rruví*, me labializimin e shpeshtë të *ë*-së në *u* në atë dialekt, në silabë përpara theksit. Për *vërrí*-në ka shumë të gjarë që të jetë një zgjerim më i fjalës *varrë* «plagë», e cila ka dhe kuptimin e vijës (*vara-vara* «vija-vija të trasha», për petka, në Dibër), te Bashkimi edhe «grado» *striscia*. Prej *varrë-s* duket të kenë dalë dhe *vurratë* e *vrragë*, sh. këto fjalë. Te *rruvjeshkull* mund të ketë ndikuar *rrjesht-i*; po dhe te *rruví* mund të ketë ndërhyrë *vi-a*.

rruzullim m. «gjithësia». G. Meyeri 371 e jep këtë fjalë pas Bogdanit dhe e lë pa spjegim. Si e pa Weigandi (Balkan-Archiv I 262), ka dalë nga *rruzull* m. «sferë» (te Bashkimi), sot «lëmshi i dheut».

Kuptimi i universit në shqipen letrare është dhënë gjatë kohëve me fjalë të ndryshme. Budi (DC 147, SC 3, 189) përdor *rrethi i shekullit*, shprehje e krahasueshme me gjerm. *Weltkreis*. Në shekullin e XIX N. Frashëri sajoi *gjithësi*-në, formim i rrjedhur nga *gjithë*, khs. librin e tij *Gjithësija* 1895. De Rada përkundrazi (Sofonisba, te Antol. alb. 77) ka substantivuar kompozitin *gjithsej*, duke formuar *gjithsë-ja*, *gjithsës* «all'universo» (sh. *send*). Nga këto krijime letrare, vetëm *rruzullim* e *gjithësi* kanë hyrë në gjuhë të shkrimit; e para prej gegërishtes, e dyta prej toskërishtes. *rruzullim* është pas gjase një sajim i Bogdanit. Sa për *rruzull*, nga e cila ka dalë *rruzullim-i*, ajo është një zgjerim me *-ull* i geg. *rruzë* «ruazë». Kjo fjalë tregon se në gegërishten monoftongimi i *ue*-së në *u* kish-te depërtuar pjesërisht që në kohë të Bogdanit, sh. *ruazë*. Junggu ka *ro-zollim*.

rryej: sh. *rienj*.

rryell m. «Euphorbia, qumështore». G. Meyeri 366 e njeh me trajtën jugore *rriell*. Për këtë paravendon një bazë oksitone *rriéll*, dhe kështu e spiegon fjalën prej një lat. së rindërtuar **aliellum*, nga *alium* «hudhër»; me fjalën e shqipes afron për krahasim rum. *alior arior* a *aior* «qumështore»; duke rindërtuar për këtë si bazë një **aliolum*. Etimologji e pranuar me rezervë te Pedersen (KZ 33, 539), po me kusht që të mund të niseshim nga një bazë proparoksite lat. **aliolum*. Khs. dhe Puscariu EW 65, Jokl IF 46, 382. Meyer-Lúbke REW f. 804 për rum. *alior* pranon mendimin e Candreas, i cili e nxjerr prej lat. *aureolus* «i artë».

Fjalë e mbarë gjuhës, me trajtat *rryell* e *rriell* sipas dialekteve, gegërisht përkatësisht *rrÿll* e *rrill*, ajo te Cordignano, kjo te Bashkimi. Edhe Gazulli jep për Veri *rrill*, me *rrill mali* «Euphorbia cyparissia», *rrill peshk* «Verbascum», meqë rryelli përdoret dhe në peshkim për helmim të peshkut. Në Shën Gjergj të Tiranës *kacarrÿll* «Euphorbia helioscopia», me pre-

fiks *kaca-*. Manni sjell për Vlorë *rryell*, po për Mat *rrell* «spurge». — Etimologjia latine nuk shkon, as nga ana e formës, as nga e kuptimit, sh. dhe *Revue (roum.) de Ling. VII 1 191*. Në punë të formës, te *rryell rriell* nuk arrihet as nga një **aliellum* as nga një **aliolum*, se të dyja këto baza do të kishin pasur të tjera reflekse. Kuptimisht nga hudhra te qumështorja largesa është tepër e madhe. Ndërkaq edhe nga pikëpamja e latinishtes dy bazat në fjalë është vështirë të pranohen. Mbi gjithë këto, ato, përveç se janë të rindërtuara ad hoc, nuk çfaqen askund nëpër gjuhët romane.

rryp, *rrip* m. «brez lëkure për të mbajtur pantallonat», edhe *rryp* i *fyshekëve*, i *opingave* etj.; *rryp toke* «një copë tokë e gjatë e e ngushtë»; *rrype* f. «*rryp*, vilar që grisim nga një pëlhurë»; *rrypinë* f. «një *rryp toke*»; *rrypák* «i fortë si *rryp*» (për mish, për pemë, për një petë); i *rrypshtejshëm* «i fortë si *rryp* e i papërtypshëm», p.sh. për një ftua; *rrypo* «ndaj *rrypa-rrypa*», *rrypohem* «bëhem si *rryp*, i thatë». Si e pa sëpari Hahni (f. 110), është një postverbal i *rjep*; khs. dhe Kamarda II 62, G. Meyer 367. Ky afrim përbrenda gjuhës është më afër meç se ai me lit. *virpas* gr. **ραπίς** «thupër, shkop» që bën Manni Language 28,37. Monoftongimi i diftongut *je* shpie në *i*; prandaj trajta primare e emrit është *rrip*, e *rryp* i detyrohet pas gjase afërsisë së labialit. Khs. për një të tillë monoftongim edhe *pjek*: *pikë*, *sjell*: *sillë*, *shtjell*: *shtill*, *vjel*: *vile*, *vjeshtë*: *vishtë*, ku trajtat me diftong janë kudo verbe, ato me *-i-* janë emra. Monoftongimi te këto lloj emrash përbën një nga problemet e fonetikës historike të shqipes.

S.

s «nuk». Boppi (f. 497) vuri re fuqinë mohonjëse të kësaj pjesëze edhe te *as* e te *mos*, të cilat ai me të drejtë i gjykon si *a-s mo-s* (sh. *as*, *mos*), edhe kur është me përdorim më vete, te *s di* «nescius» (Bardhi), *s mund*, *s ban*, *s ha*. Ai sheh te *-s-ja* e *as-it mos-it* një shtesë thjesht fonetike, po mundësisht edhe një dëftor që lidhet me *so-* e *si-* në *sot sonte sivjet*. Khs. dhe Kamardën I 102, 312. G. Meyeri 376 *s-në* e bie të ardhur prej lat. *dis-*, në fillim përftuar në verbe të përbëra, duke dalë pastaj dhe më vete. Pederzeni (f. 184, KZ 36, 321 e 341), duke vënë në dukje se lat. *dis-* ka dhënë në shqipen *ç-*, *s-në* e afron në rendin indoeuropian me arm. *ç*, *oç* «nuk». Mendim që pëlqehet te Tagliavini 242 e te Bariçi Hymje 43. Jokli (Arhiv I 37v.) te *s-ja* në *mos* pranë *mo* sheh refleksin e një teme përemërore që hyn në grupin e *sa si se* e që sipas tij më konkretisht ka dalë nga *si* me apokopë të *i-së* fundore; kështu *mos* sipas tij i përgjigjet morfologjikisht e kuptimisht gr. **μήπως** «mos» në fjali pyetëse.

Fjalë e mbarë gjuhës. Del më vete dhe në disa pak kompozite, verbale e nominale, si (*smund* «jam sëmurë») *sëmunë sëmurë sëmundë sëmundje*, *skam* m. *skame* f., *smir*, *spagjë* (*paq*), sh. Xhuvani-Çabej Bul. për Shk. Shoq. 4(1956) 93. Nga autorët e vjetër të Veriut Buzuku nuk e përdor, po ka gjithherë *nukë*. Bardhi jep *Non est S ashtë*, *Non amo te S të due*, *Non sum ego S jam u*, f. 200 *S ashtë emi* «Non est meum», duke e shkruar konsekuentisht bashkë me fjalën ndjekëse, zakonisht verb. Si e kemi shtjelluar dhe në Bul. për Shk. Shoq. 1 (1956) 141 shënim, te *sëmunë sëmurë* kjo fjalë del në një trajtë më të plotë së; poashtu si pjesëz mohimi në shqipen e Greqisë (*e kozmi atë së njohu*) e te Variboba në Kalabri (*Ma së kuxxoi te i rëfien*). Kjo së për ne është forma primare e fjalës. Ajo si pjesëz e pathekse që ka qenë gjithmonë, me përdorimin e shpeshtë e me shqiptimin e shpejtë, në pozicionin proklitik ku gjindet rregullisht, humbi vo-

kalin e u rrudh në *s*. Historikisht *s*, më e vjetër së, është forma e reduktuar e përemrit pyetës se «çë», (*me se, për se* etj.), *e*-ja e të cilit në proklizë u shurdhuan rregullisht në *ë*. Kuptimi i fjalës ka kaluar nga «çë?» në «asgjë», ashtu sikundër në gr. e re **τίποτε** «asgjë» rrjedh nga **τί ποτε** «çfarë pra». Më tej nga «asgjë» u arrit te «nuk». Edhe këtu ka një analogji në greq. e re, ku **δέν** «nuk» ka dalë nga gr. e vj. **οὐδέν** «asgjë». Gjithsesi kjo pjesëz mohimi e shqipes si trajtë e si kuptim u ka formuar brenda fjalisë, ajo është një produkt i sandhit. Pikënisja do kërkuar në fjalitë pyetëse që paravendonin një përgjegje mohuese, siç janë ndër të tjera pyetjet retorike si *ç'di unë?*, të cilat dhanë pastaj fjali mohimi. Stilistikisht *s* paraqitet më popullore, e si e tillë më pak e hollë se *nuk*. Mbase këndeje spiegotet mungesa e saj te Buzuku. Përveç kësaj *nuk*, me trajtën e saj të vjetrën *nukë*, edhe fonetikisht paraqitet më e plotë, më ekspresive e akustikisht më e ndieshme se *s*-ja. Prandaj ia ka zënë vendin sidomos në gjuhë të shkrimit. Me këtë ndërkaq asgjë nuk del për punën e kronologjisë relative të së dy lidhëzave. Përkundrazi, gjithshka flet në të mirë të një vjetërsie më të madhe të lidhëzës *nukë*.

salikó «kryej ceremonitë e një varrimi»; **salikím** m. Fjalë e geg. veriore, sot e përgjithësuar, e cila mungon te G. Meyeri. Del sëpari te Jungu, si *me salikue* «far le esequie», *me salikue vorret* «benedire i sepolcri»; te Bashkimi edhe emri **salikim** «benedizione del sepolcro, funerale», te Godini «Grablegung». Forma më e parë niste me *ps*-, ashtu si na ruhet te Budi: RR 157 (Të ciatë kafshë duhenë me qenë bām ndeevonë mbë të vorruomit) . . . *ndjerë të mbaronenë gjithë këto psalikime e uratë e cerimonie qi kemi këtu me i vūm për fundit; e me u goditunë mā parë, për pagëtyrë të oficiesë, e të Meshësë, e të psalikimit, e të tjeravet cerimoniave; . . . ashtë qysh moti dhanë e urdhënuom, qi ndë qishdo koho të shpūretë i vdekuni me u vorruom, ō të psalikonetë, e t'i bahenë të tjeratë oficie, e cerimonie, f. 359 Të psalikuomitë e oficia e tyne. Është në thelb një me *psal psaloj* «këndoj këngë fetare në kishë» bashkë me *psalt psaltir* etj. që vijnë prej gr. së re **ψάλλω** (sh. G. Meyer 355). Veçse si një fjalë e geg. veriore katolike rrjedh prej italishtes: *salmo* pranë *psalmo* «psalm», *salmodia psalmodia* «këngë fetare kënduar në kishë», *salmodiare psalmodiare* «psal, psaloj». Mbi këto dëshmi fjala mund të jetë marrë pa *p*- prej italishtes. Po mund ta ketë bjerrë këtë tingull dhe brenda shqipes; khs. *shelinok*: *shelinok*. Në shqipen fjala ka pësuar një shpërngulje të kuptimit; nga këngët që këndohen në ceremoninë e një varrimi ka arritur të shënojë vetë këtë ceremoni, e në të folët e zakonshëm edhe varrimin vetë.*

sanëp m. «sinap». Del, si një **ἄπαξ εἰρημένον**, te Buzuku (LVIII = LXVIII, Eksodi 12, 8): *e ta hanë me bukë fogace e me sanëp që anshtë i fortë* «Et edent. . . et azymos panes cum lactucis agrestibus». Vjen nga it. e vjet. *sánapa* për të sotmen *sénapa*. Poandëj rrjedh dhe mbiemri fem. i tosk. jugore *sarpe*, në shprehjen *fjalë sarpe* «fjalë e vrazhdë» (Gjirrokastër), ku rotacizmi dëshmon për një trajtë të dikurshme *sanëp* që piqet me atë të Buzukut. — Sh. dhe *sináp*.

sefërgjén m. «borzilok». Për këtë emër bime G. Meyeri 44 (te *bozë-lók*) përveç *sefërgjén* jep edhe formën *fesëlgjen* dhe e nxjerr me të drejtë nga turq. *fesleken*, kjo prej gr. së re **βασιλικόν**. Fjala turke ka pësuar në gjuhën shqipe shumë ndryshime: *filcigén, filzigén, filzegén, felzigén, fasligén*, me metatezë *sefërgjén, selfián, selfiόν, silfján, selfigán, selfigén, seffén* etj., sh. Weigand 78, Mann 107, 448. Për formën *karafilxigén* me tura. *kara-* sh. Xhuvani-Çabej, Bul. për Shk. Shoqërore 4 (1956) 75. — Për

përhapjen e fjalës në gjuhët ballkanike khs. sidomos Skok, **Σις μνήμην Σμ. Λάμπρου 463^{vv}.**

sembër, sēmbēr m. «bujku që bëhet ortak me një tjetër në parmendë, duke vënë të dy nga një ka në zgjedhë e duke punuar arat e tyre me radhë, gjymsatar; stanari që bashkon bagëtinë e tij me një tjetër për një kohë pak a shumë të gjatë, përzitës, qinosiar, (i) shmriak». Mungon te G. Meyeri, del sëpari te Tasi si *sēmbēr* «shok në bagëti, **συγκοινωνός συνεταιρός**». Sipas Joklit (Sbornik Miletić 121^{vv.}, 659^v), bashkë me gr. e re **σέμβρος σεμβρός** «gjymsatar; përzitës» fem. **σέμβρα** «gjymstare», me rum. *sīmbră* «bashkari; bashkim dy vetash në bagëti si përzitës a në punim të tokës si gjymsatarë» *sīmbaş* «përzitës; gjymsatar», magj. *cimbora* «shok», lit. *sēbras* «gjymsatar, shok», është huazim nga një fjalë sllave, e cila ruhet në serb. e vj. *sebr* «gjymsatar, shok» serbokr. *sebar* «gjymsatar; bujk», slloven. *sreb r, srebra* «bujk», rus. *sjabjor* «fqinjë, shok, mik, ortak; anëtar me votë i kuvendit». Për përhapjen e fjalës në këto gjuhë flet më parë G. Meyeri NS II 56^{v.}, pastaj Thumbi IF 14, 347^{vv.}, Tiktini III 1425 e autorët e tjerë që përmend Jokli. Për burimin e fjalëve të gjuhëve të tjera prej sllavishtes janë të gjithë me një mendje, po për çështjen e gurrës së fjalës sllave mendimet ndahen. Sceptik ndaj etimologjive të mëparme tregohet Vasmeri REW III 62. Ai kundërshton dhe spjegimin që jep Jokli, i cili bazën e gjen te një **sēm-bur* «me fitim për gjysmë, gjymsatar» që i përkiste sipas tij një gjuhe gjermanike lindore. Përkundrazi këtë etimologji duket se e mbron Tagliavini (IJ XXV VII 236) përkundrejt M. Mladenovićit. Për lit. *sēbras* let. *sebrs* sh. tani sëfundi Fraenkel 768^v.

Fjalë sot krahinore e toskërishtes, po që nga ekzistenca e emrit të krahinës *Semberija* në Bosnje sipas Joklit duhet të ketë qenë e gjallë dhe në Veri. Për etimologjinë e saj peshon kjo rrethanë, që në disa ligjërime të toskërishtes kjo piqet me trajtat që ka marrë atje fjala *shemër*. Kështu shemrës në Tiranë e poshtë gjer në Lunxhëri i thonë *shembër*, po në Dukat të Vlorës atë e quajnë *sēmbrī* (Q. Haxhihasani BSS 4, 1954, 143), në Qeparo të Himarës *sēmbrja* pl., në Kolonjë *ksembër*. Në këtë mes del pyetja a kemi të bëjmë me ko incidencën gand të trajtave të dy fjalëve të ndryshme apo me bigëzimin e një fjale të vetme në dy fjalë me forma e me kuptime më vete. Këtu disa të dhëna dialektore dëshmojnë në të mirë të mendimit të dytë. Në Zagorie e njëjta fjalë përdoret me të dyja kuptimet: *sēmbēr* «shemër», po *punojmë me sēmbēr* «punojmë me dy qe, si gjymsatarë» (M. Totoni, BUST Seria Shk. Shoq. 1, 1962, f. 211); anasjelltas në geg. veriore një zgjerim i *shemër-s*, (i) *shmriják*, do të thotë «përzitës, qinosiar» (në bagëti), e abstrakti *shmrijákí* f. shënon te qenët përzitës me një, qinosinë. Semantikisht kalimi nga kuptimi i dy grave që kanë të përbashkët burrin ose dashnorin te kuptimi i dy grave — e pastaj dhe i dy burrave — që bashkojnë qetë në pendë ose tufën e bagëtisë, nuk është edhe aq i vështirë sa duket.

send m. «gjë»; *gjēsēndi* «gjëkafshë». Hahni 113 e jep si fjalë gegërisht *send*-i «Sache», *gjithë ç'farr sendi* «jeder Art Sachen, Gegenstände». Edhe G. Meyeri 381 e sjell si fjalë të gegërishtes, *sent sen, gjēsēnt gjēsēndi* «gjëkafshë», dhe kufizohet me shënimin «sipas Reinholdit fjalë turke». Më parë Kamarda (I 335) pëlqente mendimin e Ascolit (Frammenti linguistici 15) që *gjë* e *send* i afronte me ind. e vj. *sant-* «që është, i mirë». Kështu afërsisht edhe Barić (I 92), duke lidhur *send*-in përbrenda shqipes me *gjë* e të dyja më tej me gr. **ντ** «që është» lat. *sont-* «faktor» etj. Ai sillte kundra Spitzerit (Mitt. d. Rum. Inst. Wien I 322), i cili burimin e *send*-it e kërkonte te lat. *genus* «gjini.» Weigandi 77 e lë të paspieguar.

VITI Fjalë e të dy dialekteve, po në këtë formë jo dhe e kolonive, pra jo e mbarë gjuhës. Për toskërishten khs. *pyeti t ëmën se mos kish ndonjë sendë pe të et* te Mitko 168 (popullorë?); për geg jugore *e ti mos ki nonji send se jam unë* «and dorn't be afraid because I'll be there» te Hasluck (Alb. Reader 78); për geg. veriore *nepi nnoj senn ktī* (Jarník Příspěvky ku pozn. nářečí albanských 15) dhe *shum senne tjera* (Lambertz Alb. Märchen 220). Puljevski (f. 9, 8, 58) *sent*, po *çetër donjisend* «drugò nešto», *nonji sen* «nešto», Kujundžići (f. 62, 31, 83) *stvar* «send» *malenkost* «sendi i vogël», *Apo ju vin juve ndoisend?* «Treba li vam štogod?» Në Veri edhe fem. *send-ja*, në Vukël (Kelmend) *rri se të han buçi e sennja*, te Gazulli *i bukur si sëndja në sy të kalit* «i mbrapësht kah duka, teshë i keq, shnjall»; prej Veriu ka dalë dhe deminutivi *sendth* m. «teshë, gjë pa vlerë», në Pukë pas Gazullit (f. 502) «il coso, teshi», *sendthi i keq* «sendja e keqe, sendja e shëplakun». E të dy dialekteve është *gjāsēnd gjēsēnd gjēsēndi*; sh. për toskërishten p.sh. S. Frashëri Shkronjëtoje 57. N. Frashëri Istori e Skënderbeut 81, 83, 86, Çajupi Përralla 40, më parë (1844) N. Veqilharxhi *t i shpëton gjēsēnt atī* (BSS III, 1952, f. 18); për gegërishten, p.sh. *prej atī qi t lypë uhā ndoj gjāsēnd* te Xanoni, Ungjilli i Sh. Mateut 5, 42; është një kompozit dy sinonimesh, i tipit it. *Mongibello*, për të cilat sh. Tagliavini 97, khs. prej shqipes *dobromirë*. Ndërtim të përkundërt të pjesëvet përbërëse, po ndërlidhur me e, paraqet se *vjen një send-e-gjā e ia han kokrrat* te D. Kurti II² 82.

Si e kemi shënuar dhe në BSS IV (1953) 36, kjo fjalë paraqet substantivimin e përemrit pyetës *se* «çka» përdorur me parafjalë, si në *me se, nga se, për se përsë*. Emri ka dalë nga akuzativi *sen*, dhe *-d-ja* është shtesa thjesht fonetike e një tingulli homorganik pas *-n-së*, poashtu si te *kënd: kë, kund: ku* etj. Për karakterin relativisht të ri të kësaj shtese dëshmon trajta *sen* te Buzuku e te Bogdani: Buzuku (LXXVII/2 = LXXXVII/2, Galatasit 5, 23, LXXXI = LXXXI, Efesait 6, 16) *tue klenë onest ndë gjithë sen* për lat. «modestia, continentia»; *tue përzanë ndë gjithë sen s(h)qytnë e fesë* «in omnibus sumentes scutum fidei»; Bogdani (I 43, 15; II 68, 17) *Nuk' anshtë i begatë aj qi ka shumë, po aj që as njiseni nukë ka nevojë* «Non est dives, qui multa possidet, sed, qui nullius eget rei» (Gjon Gojëarti), *me goditunë qi të përkisnë kund ndë një sen të mbytunë* «se per sorte toccassero qualche cosa soffogata». Kështu *send* me këtë formë është një fjalë relativisht e re, e cila si *sen* kishte lindur në Veri në kohën para Buzukut, po në Jugë nuk u kish formuar në kohën përpara shpërnguljes arbëreshe n'Itali. Në ato dialekte ndeshim në të tjera substantivime të *se-së* me kuptimin e një gjēsēndi: de Rada *gjithsēs* «all' universo», *të Gjithsēs* «delle universe cose» (Antol. albanese 77, Fiam. Arbërit II Nr. 5 f. III), A. Nociti *gjithsē e gjithsēt e mia* «omnia mea» (G. Meyer Alb. Grammatik 70, 71), Santori (te K. Kamsi, Leka XV 74, 110) *Burri që vanto het se di shumë seja, e kjo seje* «kjo, kjo gjë». Te *se-ja* përemri *se* u substantivua pa pësuar ndonjë ndryshim forme, khs. *pse-ja*; te *send* u bë një emër më vete edhe nga pikëpamja e trajtës. Kronologjia relative e tri emrave që përmbajnë idenë e sendit në shqipen: fjalët e vendit *gjë gjā e send* dhe *kafshë* nga lat. *causa*, është kjo, që më e lashta është *gjë, gjā*, më e reja *send-i*, në mes qëndron nga pikëpamja e kohës *kafshë*.

serotinë f. «vesë a lashtë që bie në mbrëmje a natën». Fjalë e geg. veriore, mungon te G. Meyeri. Del te Fishta, te Lahuta e Malcís p.sh. (Kanga V, f. 56) *Aklli, bora e serotina*, poashtu Kë. XVI f. 183 (Kulshedra) *Kah bje djell e serotinë*, te Vallja e Parrizit 1941 f. 23 e te Jerina (HD XVI 440) (*Veçse voes e serotinë*. Nga it. *serotino*, fem. *serotina* «që piqet vonë; vjesh-tak; i mbrëmjes», për të cilën sh. Merlo, I nomi romanzi delle stagioni e

dei mesi 72, Meyer-Lübke REW 7854. Pas përhapjes dialektore më fort prej venecianishtes. Huazim jo shumë i vjetër, sikundër tregon ruajtja e s-së si e tillë.

sëmbój: më sëmbón (me dativ) «më cëmon, ndjej ku e ku (kur e kur) të dhëmbura si të pickuara, si të qukura, që nuk mbajnë gjatë», figurshëm «më mbeti peng, pendohem»: më sëmboi që nuk shkova; sëmbím m. «të sëmbuarit, peng, pendim»: mos e ki sëmbim. Fjalë e toskërishtes, që mungon te G. Meyeri. E jep sëpari Kristoforidhi për Përmet, si verb impersonal të vetes së tretë, më sëmbon «më mbëlson, më kësen». Ekziston, me gjithë se më pak e përhapur, dhe transitivi sëmboj «prek, lëndoj» (me kuptim konkret), që e ka dhe Leotti: «angosciare, dare angoscia, affannare». Gjyrokastri si verbin si emrin i përdor vetëm metaforikisht; Çekrezi sëmbim e ka për «pang, twinge». Etimologjikisht Lambertzi (Li. Po. VII 88) sëmbon e lidh me verbin dhëmb, dhimbem, si një zgjerim të këtij. Sikundër u shënuar shkurt dhe më lart, te cëmoj (BUST. Seria Shk. Shoq. 1, 1961, f. 64), sëmboj nuk është veçse një variante e cëmoj, me ndrim c:s e me epentezë të një b-je si tingull homorganik pas m-së. Kuptimi abstrakt ka dalë, si shpeshherë, nga konkreti.

sëmurë sëmunë (i), në Kalabri sëmúrm; i sëmunët «shëndetlig», sëmundë sëmundje f.; sëmúr «bëhem shkak që të sëmuret», sëmurem «bie sëmurë», sëmúj «sëmur» sëmuhem «sëmurem»; sëmurje f. «të sëmururit, sëmundje». Sikundër e pa G. Meyeri (f. 291), e më parë Hahni (77, 116) e Kamarda (I, 101, 312), ka dalë nga s'mund «nuk mund, nuk kam fuqi», shprehje që përdoret edhe sot për «jam pa qejf». Sh. edhe Pedersen 165, Weigand 77, Tagliavini 245.

Fjalë e mbarë gjuhës. Te Buzuku (XL, Korintasit II 11, 29; XLV, Gjoni 5, 3v.) *Kush u sëmü, u nukë sëmuhem?* «Quis infirmatur, et ego non infirmor?»; *E ndë ta dergjë e madhe shumicë n së sëmunësh . . . ashtu aj shëndoshë n qishdo sëmunde aj të kish* «In his iacebat multitudo magna languentium . . . sanus fiebat a quacumque detinebatur infirmitate»; Budi (RR 80) *të ja shtjerrë ndërmenđ atı t sëmünit*; Bardhi Aeger I *sëmutë*, Aegrotare Me u sëmutë, Aegrotus Sëmutë, Infirmitas I sëmunë. Formimi i konceptit të sëmundjes nga ai i të pamundurit është ballkanik: me sëmurë sëmundje piquet arom. *niputut niputeare*, gr. e re *ἀνήμπορος ἀνημπορία*, bullg. *nemošten iznemošten*, sh. P. Papahagi, XIV. Jahresber. d. Rum. Inst. Leipzig 142, Nr. 215, 216. Për formën e fjalës shqipe duan bërë ndërkaq këto vrejtje: Përsa i përket silabës nistore, ajo jo vetëm në toskërishten, po dhe në geg. e vjetër (te autorët e Veriut) ka qenë së- e plotë; kjo, përkundrajt Pedersenit (f. 199), bashkë me disa rrethana të tjera dëshmon se pjesëza mohore s' ka qenë së, sh. BSS 1 (1956) 141 shënim. Në trup të fjalës, rotacizmi te sëmurë tregon se -d-ja fundore te mund është një shtesë fonetike sekundare, sh. BSS IV (1953) 36 dhe këtu më lart te mund. Për sufiksin -ë te sëmundë e -je te sëmundje khs. Jokl LKU 105 e Xhuvani-Çabej Prapashtesat 139v. — Morfologjikisht sëmurë sëmunë është leksikalizimi i një fjalie, e më tej një particip i adjektivuar. Për historinë e artikullit prepozitiv e për gjenezën e vonë të tij është me rëndësi të vrehet që kjo fjalë në literaturën e vjetër na del shpeshherë pa këtë element, në të renë përkundrazi me të: Buzuku (XLIV, Mateu 25, 44; LXXIX/2—LXXXIX/2, Luka 5, 31) *Zot, kur na tÿ pām se ishñjē . . . sëmunē . . . ?* «Domine, quando te vidimus . . . infirmum . . . ?» (përkundrazi Grigori Zot, *kur të pam . . . : të sëmurē . . .*, Kristoforidhi . . . të sëmunē . . . , Zanoni . . . , t'smuet . . . , sh. Studii si Cerc. lingvisticæ X 4 f. 548); *Nukë duhetë mjekÿ atyne qi janë shëndosh, por atyne qi janë sëmunē* «Non egent qui sani sunt medico, sed qui male

habent», Kristoforidhi për ata qi kanë keq. Edhe Bardhi, si u pa, pranë Aeger I sëmutë e Infirmitas I sëmunë ka Aegrotus Sëmutë. Edhe sot pranë i sëmurë thuhet jam sëmurë. Këto fakte tregojnë ndër të tjera se artikulli prepozitiv iu ngjit me kohë mbiemrit për ta cilësuar me një mënyrë më karakteristike si të tillë.

sillë f. «buka e mëngjesit që i shpiket bujkut në arë paradreke më nja ora dhjetë; buka e mëngjesit; koha kur hahet silla»; sillóy «ha sillë»; te Pederseni *sëllí* f. «sillë» *sëllíj* «silloj», poashtu dhe në Breg të Detit (M. Totoni). G. Meyeri 384 e jep si mashk. *sill-i* dhe e lë pa spjegim. Pederseni (BB XIX 299, Kelt. Gram. I 45) lidh me të me të drejtë dhe fjalën *esëll*, që del kështu me kuptimin «pa sillë», mendim që pranohet dhe te Jokli LKU 315. Për *sillë* vetë Pederseni më vonë (Philologica II 114) shtron si bazë një indoeur. **kuilo* **kuilā*, po pa u shprehur më tej për këtë. Më parë Bariçi (I 59) *sillë*-n e nxirte prej një **a(u)sihlā*-, duke e çuar fjalën te një indoeur. **āusōs* e duke e krahasuar kështu me ind. e vj. *usāh* gr. *ἔωσ* «agim» *αὔριον* «nesër», sllav. *utro* «agim, muzg i mëngjesit» etj. Manni (Language 28, 35) përsjat mundësinë e një afrimi të *sillë*-s me çek. *čila* «kohë», morav. *v-čil* «tani», ags. *hvīl* «çast, kohe».

Fjalë e mbarë gjuhës. Del sëpari te Bardhi: Ientaculum *E silme* (E sillme) e te Bogdani (I 167): *Ulkonja zemëratë jau hā me sillë*. Në pjesën më të madhe të truallit gjuhësor të shqipes mbizotëron kjo trajtë me *s-*. Ajo sundon në Toskëri e në Shqipëri të mesme, khs. te Hasluck f. 32 *Goca e kishte marrë sillën, do me thënë, bukën e mnjesit*; edhe në Kosovë (te një këngë) *ta due sillën në xhami* (Visaret e Kombit IV 9). Në geg. veriperëndimore i thonë *cillë cilë cile*; khs. Jungg, Bashkimi, Gazulli 409, M. Sirdani Skanderbegu mbas gojëdhanash 200; te Kurti (HD XIV 11, Prralla kombtare I² 17 shën. 2) *cillë* «buka qi hahet paradite, mbasi puntori të ketë bâ nja dy orë punë». M. Sirdani (HD VI 550, 559) jep për Krajë edhe verbin *me cilë*: *Po vjen koha për me cilë; kur ka ardhë koha me cilë*. Sh. dhe Folklorë II 171. Gazulli sjell dhe *cilore* f. «shtrojë treveze, sofrabez». Nga shtrirja gjeografike (area maggiore) dhe nga dëshmia e autorëve të vjetër të Veriut shihet se forma me *s-* është primarja dhe se e sotmja me *c-* e geg. veriperëndimore është relativisht e re, duke dalë nga një fortim i sibilantit në afrikatë, si te *asi*: *aci*, *asosh*: *acosh*, *sipër*: *qipër*. Etimologjikisht *sillë* paraqitet si një postverbal i *sjell*, zgjeruar me sufiks *-ë*, zgjerim i shpeshtë në gjuhën shqipe: *çojë*: *çoj*, *ngecë*: *ngec*, *prishë*: *prish*, *pritë*: *pres* *pritun* etj., sh. Xhuvani-Çabej, Prapashtesat 39v., *gjellë*: *gjell* «rroj» (Buzuku XXVib), *trembë* (Bogdani I 35, 13), *lidhë* (Jokl, Studien 90). Për reduktimin e diftongut *je* në *i* në emra postverbale khs. *rjep*: *rrip* *rryp*, *shtjell*: *shtill* «bosht», *tjer*; *tirk*, *vjel*; *vile*, sh. BSS 3 (1954) 96; khs. edhe *derr*: *dirk*, *djersë*: *dirsë*, *vjet*: *viç*, *nip* etj. Për kuptimin do vënë re se fjalët që duan të thonë «sjell, bie» japin shpeshherë emra pjatash e së ngrënash; khs. lat. *ferculum* «pjatë»: *fero* «bart, sjell, bie»; frgj. *mets* pl. «gjellë» nga lat. *missus* «vënë përpara»; serbokr. *pōnude* «gjellë e pije që i shpien të sëmurit» (te Ristić-Kangrga I 708): *ponuditi* «me mblatue»; prus. e vj. *pērdin* «hej, tagji», fjalë për fjalë «që është vënë përpara» (Fraenkel 643). Prej shqiqes vetë hyn këtu te *vāta* fpl. Drejtpërdrejt vërtetohet burimi i *sillë*-s nga *sjell*, si një particip i vjetër, me anën e formës e *sillme* që ka Bardhi e që jep dhe G. Meyeri për gegërishten, e cila paraqitet edhe sot si një particip me *-m* i këtij verbi. — Sh. edhe *sulem*.

simahuer, *-ori* m. «ai që i lehtëson punën a që i sheshon rrugën atij që bën një vjedhje a një vrasje». Fjalë e geg. veriore, që s'e ka G. Meyeri; e jep sëpari Bashkimi, si «compagno d'armi, compagno d'azione di rappre-

saglia»; më shkoqur e spiegon me vlerën e drejtësisë popullore Gjeçovi te Kanuni i Lekës f. 77, 83. Sikundër na mëson Jokli (IF 44, 61v.), është një zgjerim me *-uer, -ori*, e semantikisht me një specializim (keqësim) të kuptimit, i gr. *σύμμαχος* «bashkëluftar, shok armësh». Fjalë e administratës bizantine, po, si shënon ky dijetar, për punë të ruajtjes së *s-së* si e tillë e të reflektimit të *v-së* greke, si *i*, huazim marrë jo para shek. të XI., afërsisht ashtu si *fis*.

sipër, përsipër; i sipërm, i përsipërm; sipret «nga sipër, së sipërmi»; *sipri sypri* «sipër, sipret», te Kristoforidhi *siprazi*. Fjalë me etimologji të diskutuar. Mendimi i Boppit (f. 499) që mund të lihet e hapët çështja nëse *sipër* është një shformim i lat. *super* apo një bashkim i *si* e *për*, riçfaqet me mënyra të ndryshme te dijetarët pas tij. Ndërsa Kamarda (I 318v.) e afron fjalën me gr. *ὑπέρο* e lat. *super supra*, G. Meyeri (f. 385) e zbërthen në *si-për*; aty *si-* sipas tij është një trajtë e temës përemërore indoeuropiane **kó-*, përngjitur me *për*, duke krahasuar ai për nga formimi fjalën *tepër*. Kështu dhe Pedersen (Festschrift til V. Thomsen 250, KZ 36, 311) te *si-sheh* ablativin e dëftorit indoeuropian përngjitur me *për*, kjo = *prej*. Thumbi (IF 14, 358 shën. 1) është për një burim nga lat. *super*. Sh. edhe Jokl Archiv f. slav. Phil. 31, 240. Në IJ XIV VII 166 ky dijetar lëfton mendimin e një burimi latin që pat dhe Mladenovi.

Fjalë e mbarë gjuhës. Për hetimin e etimologjisë peshon rrethana që ajo te burimet letrare të vjetrat çfaqet më shpesh në trajtën e përngjitur e aty më shpesh si adverb. Buzuku (XXXII, Isaia 45, 8; LVI/2, Gjoni 7, 30; XLIII, Mateu 4, 6; LXXX = LXXXX, Luka 13, 13; LXIV/2, Mateu 26, 50) *Kthielli, ju qiell, përsipëri, e rëtë kthjellnjënë gjyqitë* «Rorate coeli desuper, et nubes pluviant iustum»; *e askush nukë i vu duortë përsipërë, përse edhe s ish hera e tî* «et nemo misit in illum manus, quia nondum venerat hora eius»; *e vu mbë konkët përsipëri të klishësë* «et statuit eum supra pinnaculum templi»; po *E i vu duortë sipërë, e atë tra u ndëreq* «Et imposuit illi manus, et confestim erecta est». Ashtu atëherë *vunë duortë sipërë Jezut* «Tunc accesserunt, et manus iniecerunt in Jesum»; Bogdani (I 5, 19, II 14, 9) *nji Lter shkruem përsipëri* «un Altare con l'iscrizione», *Voelsoni o Qiell përsipëri, e Rëshit shijoftë i dërejti* «Rorate Coeli desuper, et nubes pluant iustum»; Lecce 200 *sipëri*; Grigori 298 *sipërit* «*ὑπερο*»; Pedersen 191 *sipër siprë*, Weigandi *sipër cipër*, në Siqeli (Piana dei Greci) *siprë*. Popullore është *syprinë* f. «faqja e sipërme e një trupi» (*syprina e bukës*), me labializim të *i-së* në afërsi të labialit; janë neologjizma *sipërfaqe f., sipraní* f. «sovrانيتet» e *sipërór, -e* «superlativ». Në toponimi të Kurveleshit (Kallarati) *Sumaku psipërm* (R. Memushaj), në atë të Moresë *Laka siprëme*. Nga mbizotërimi i trajtës *përsipër(i)* ka të gjarë që kjo trajtë të jetë morfologjikisht primarja, që fjala të jetë një kompozit për *s ipëri*, me ndërtim ablativi, ashtu si shumë adverbe të shqipes: *përposh, përpjetë, përfundi* (Buzuku LV/2 = LXV/2b *përfondi*), *përtej, përsëri(u), përseslli, për së largu, për së mbari, për së prapthi, për së vogli* etj. Nga pikëpamja e formimit *përsipër-s* i përgjigjen plotësisht lat. *desuper* «nga lart, nga sipër», frgj. *dessus* nga *des sus*, rum. *despre* «përmbi», pas mendimit të përgjithshëm prej lat. *désuper*, për mendim tonë nga rum. *de* e *spre* «përmbi». Kështu kuptimi i parë i fjalës shqipe është «nga sipër, prej sipri», dhe *-s-ja* te *për s ipëri* është artikulli prepozitiv i ablativit së. Baza e fjalës gjan të jetë *për, s épëri* «për së nalti», ablativi i *i epër* «i sipërm»; trajta e thjeshhtë e kësaj gjindet te Budi (DC 212b): *S epëri u jam dërguom*. Këndej rrjedh dhe *i-ja* fundore te *përsipëri*, e cila pastaj ra, ashtu si *-u-ja* te *përsëriu*:

përsëri. Me etimologji popullore të gabuar *përsipër* u zbërthye në *për-sipër*, dhe kështu u shkëput *sipër* e doli fjalë më vete. Ndërkaq te *për s'ëpëri* ndrimi e : i mbetet për të sqaruar.

sivonë «fytyrë e hieshme». Këtë fjalë të de Radës (Ser. Topia 53, 59), që e jep italisht me «viso delicato, sembiante dolce», G. Meyeri 386 e lë të paspieguar.

Nuk është gjë tjetër veçse *sinë*, akuzativi i fjalës *sy*, në Kalabri *sī*, me -vo- futur në trup fjale, sikurse në fund fjale te Kamarda (II 129, 130) *trim i rivo* «trim i ri», *hën e revo* «hënë e re». Sikundër na mëson H. Pedersen (Festschrift til V. Thomsen 254), kjo *vo* s'është veçse o-ja e thiores (*zonjezó, djaló, motró, djelmó* etj.), me një -v- që ka hyrë për të zhdukur hiatin. Pra fjala do shqiptuar *sivonë*, dhe s'është femërore. Si *i rivo* dhe *e revo* është formuar dhe *javo* «ja, që», për të cilën sh. më lart te *ja* I.

skanj skâj m. «anë, buzë, qenar; kënd, qoshe»; në gjuhën e sotme edhe «term shkencor»; *skajój* «vendoj, instaloj», si term gramatikor «i jap trajtën e shquar një fjale», *skajím* m. në gramatikë «të skajuarit». Këtë fjalë të geg. veriore G. Meyeri 174 e jep me trajtën *skê* dhe e lidh përbrenda shqipes me *kënd kand* «qoshe». Pas Joklit (LKU 116, Balkangerm u. German. im Albanischen 126) vjen nga sllav. *konъ*, «qëllim, fillim, qoshe» (serbokr. *od kona do kona* «nga krei e gjer në fund»), me shtesë të prefiksit shqip *s-*. Pranuar te Mladenovi (Balkan-Archiv I 65), te Selišćevi 197, 326 e te Xhuvani-Çabej, Bul. për Shk. Shoq. 4, 1956, f. 93, edhe te ne BSS 3 (1954) 74, Li. Po. VII 189.

Bogdani ka (II 101, 9) *unë kam gjithë herë mballëfaqe predikuem Di-jenë teme, e jo tinëzë, skanjevet* «io ho sempre pubblicamente predicato la Dottrina mia, e non nascostamente nei cantoni. Spiegimi nga sllav. *konъ*, për arsye fonetike nuk ecën. Fjala është një me *skanjë* (Bregu i Detit) çam. *skanjo* «karrigë», që është një huazim prej italishtes (sh. këtë fjalë). Kuptimet «shkamb, karrigë» e «anë, zgrip, qenar» piquen ngandonjëherë. Khs. prej shqipes *shkamb* «fron, stol; karrigë», që në shumësin *shqem (shqemi i derës) shqim shqimth shkim* ka dhënë «praku i derës», sh. Li. Po. VII 197. Për «stol, fron; karrigë» si kuptim i parë dëshmon edhe verbi *skajoj* «vendoj, instaloj». E sotmja *skâj* ndaj *skanj* do gjykuar ashtu si «*brû(jë), zôjê* etj. Trajta *skê* rrjedh nga ndrimi i *a-së* në një *e* të hapët në geg. veriore. Sh. për këtë Li. Po. VII 200, me literaturë (N. Jokl).

skëterrë f. «ferr». Mungon te G. Meyeri. Gjindet te N. Frashëri (Qerbelaja 19, 125, 151, Istori e Skënderbeut 170), te Kalendari Kombiar 1909 (f. 59) si një fjalë e re që ka nevojë për spjegim, e te Diturija I (1909) 70, në vjershën «Bujku» shqipëruar nga Trophées-të e J. M. de Hérédias. Është një kompozit *skë-terr* «vend i errët», sh. Xhuvani-Çabej BSS 4 (1956) 95. Te Cordignano gjindet dhe mashk. *skëtërr-i*, e te Manni (P. Poga) edhe verbi *skëtërr* «errësoj, bëj të errët». Kemi të bëjmë me një fjalë kulture me gurrë popullore. Për këtë dëshmon emri i katundit *Skutër* në Qafë të Kërrabës, me miniera thëngjilli, formë me velarizim të *ë-së* në *u* në silabë paratheksore, që nuk duket të jetë dhënë drejt si *Skëterr* te Gazetteer of Albania 168. Ndërkaq nuk dihet nga ç'dialekt e kanë marrë fjalën shkrimtarët e parë që e përdorën.

skundËll m. «pëqi, shpëlqi i petkut, kind». Këtë fjalë të geg. veriore (sëpari te Bardhi, Fimbria *Skundilli*) G. Meyeri 174 e spjegon nga një *lat.* e rindërtuar **cantile* prej *cantus* «gavyell, qoshe, rreth», duke e afruar për-

brenda shqipes me *kënd kand* «qoshe» që sipas tij është it. *canto* (në shqipen e Greqisë *kandún* nga gr. e re *καντόνι*), me *shkëndëzit* «ndresat» në Itali e me *skê* «skanj», afrime thujse të gjitha jo të drejta (sh. këto fjalë); sigurisht i padrejtë është edhe spjegimi i *skundill*-it nga një **cantile* që nuk haset gjëkund në latinishten e as në gjuhët romane. Më afër menç është spjegimi i fjalës nga një sllav. *skut* «kind, prehër», sikundër mendon Kristoforidhi f. 500. Kjo, me epentezë «popullore» të një -n-je, dha **skund*, kjo në shumës **skundínj*, nga e cila me rrugë retrograde u formua rish-tas *skundî* e prej kësaj *skundill*, si një plural i singularizuar; sh. dhe BSS 3 (1954) 74v., Li. Po. VII 189v. Për formimin me -ll, me *skundill* le të krahasohet *thëngjill*. Kështu fjala na del e afër me *skutë*, *skutinë*, *skutace* (sh. këto fjalë). Trajta *skundî*, shkruar *skundín*, është e dokumentuar, Bogdani (II 56,19) ka *skanj e skundinit* «l'orlo delle vestimenta». Kësaj prej geg. jugore (Graceni i Kërrabës, M. Çeliku) i përgjigjet *skuni-a* f. «arnë». Kështu trajta *skundill* për morfologjinë e saj nuk duhet të jetë e vjetër në shqipen; në atë drejtim dëshmon edhe ruajtja e s-së. Në Veri rrjedh prej serbokroatishtes, në anët e Kërrabës prej bullgarishtes.

skutë f. «kënd, qoshe, buxhak; vrimë për t'u fshehur», pas Mannit edhe *skut*-i m. *skutliq skutaliq* m. «skutë e vogël»; *skutem* «tulitem», *u skuta në rranxë t'ullinit*; *skutój* «ngrë një gjë, e vë mënjanë për ta ruajtur»; *skutlój* «vë mënjanë, ruaj, aufsparen, bewahren, it. mettere in ripostiglio, conservare»: *zôja e shpisë e skutlon harxin për ditë të ngushtë*. Fjalë kryesisht e Veriut (*skutem* dhe e Myzeqesë), e cila mungon te G. Meyeri; e kanë fjalorët pas tij, si Junggu, Bashkimi, Cordignano, Gazulli, Manni. Në Vjerdhë (lokaliteti i Hajmelit) pas Nopcsas (f. 81, 83) *skot* «kamare e vatrës», me ndrimin *u : o* të geg. (veri)lindore. Nga sllav. *kut* «qoshe, kënd, cep», me prefiks s-shtuar në shqipen. Në geg. veriore huazim prej serbokroatishtes, në Jugë prej bullgarishtes. Me prefiks *ra-* prej *r(r)ë-* është formuar *raskutë* f. «shpellë në një shkëmb», që jep ER (te Manni) për Petrelë të Tiranës.

spikás spikát «dal në pah, shquhem, dal përmbi të tjerët, dallohem»; *spikatem* «spikat». Fjalë e geg. veriore, me kohë përgjithësuar në gjuhë, që s'e ka G. Meyeri. E jep sëpari Bashkimi, me *spikatë* «risaltare in forma plastica, spiccare», bashkë me emrin *spikamë* f. «reliev», i cili do të jetë një sajim i redaktorëve të këtij fjalori. Nga it. *spiccare* intrans. «me u dukë, me dalë, me spikatë». Verbet latine e italiane më -are janë grupuar në shqipen te klasa më -oj. Përkundrazi ky verb ka hyrë në klasën më -as -at -atem, që pas gjase e ka burimin në sllavishten, si te *vikás vikát*, te Buzuku *shetatën*, në fjalë shqip *degatem*, *fijatem*. Forma *spikój* që pritej të ishte, del një herë te Gazulli (f. 243), te *lyeth* «kokrrizë mullá qi spikon jashtë vizës së ndrejtë e së dëjun», a fjalë popullore, a e sajuar, nuk dihet. Helbigu 75 prej it. *spiccare* bie të ardhur një tjetër fjalë të shqipes, me *shpikë* «staccare», që ka Junggu. Ky spjegim do të ishte i drejtë nga ana e italishtes, ku *spiccare* trans. e ka kuptimin «shqit». Po për *shpik* nuk vërtetohet një domethënie e tillë, dhe kjo është një denominativ i *pikë*-s (sh. *shpik*). Dhe formalisht një kalim nga it. *spiccare* në *shpik* s'është i besueshëm.

spithâr m. «gropëz e vogël në mal, mbushur me ujë, ku pinë njerëzit e bagëtia». Fjalë e toskërishtes (Gjirokastra, Zagoria, Tragjasi i Vlorës), e paregjistruar gjer më sot. Del dhe në këngën *Dolla moj dolla Në majë të malit. Piva moj piva Ujët e spitharit. Hëngra moj hëngra Majëzën e barit*.

Gjeçë moj gjeçë Thëllënzën e malit (kumtuar prej Prof. Th. Papapano-Çuçit). Në Kallarë të Kurveleshit *Qaf' e cpitharit*, një vend me gurë e me gropë që mbajnë ujë (R. Memushaj). Huazim, me shtesë të një prefiksi *s-* (sh. për këtë Xhuvani-Çabej BSS 4 1956, f. 93v.), nga gr. e re *πίθάρι* «bote, shtamë», te Legrand «cruche de terre, jarre». Shpërngulja e kuptimit rrjedh nga gjasa e formës së këtyre gropëzave me qypat e shtamat.

sqeptore f. «Scolopax, shapkë, shaptore». Mungon te G. Meyeri, e jep Kristoforidhi për të folët e Shkodrës, Zadrime e ka *sqeç-a*. Janë zgjerime të *sqep-it* një herë me sufiksin e agjentit *-tor-tore*, një herë me *-ç* fem. *-çë*; sh. për këto sufikse Xhuvani-Çabej Prapashtesat 92 vv., 29. Edhe në të tjera gjuhë ky zog ka marrë emrin nga sqepi jashtëzakonisht i gjatë që ka; khs. it. *beccaccia*: *becco*, gjerm. *Schnepfe*: *Schnabel* «sqep», Kluge-Goetze 536. Me *sqep* janë formuar në shqipen dhe disa të tjera emra zogjsh e shpendsh: *sqepgjatë* f. «Haematopus ostrealegus», *sqepkúq* m. «*Loxia curvirostra*», *sqeplugë* f. «*Platalea leucorodia*».

sqerbul m.: sh. *gërbulë*

sqimë f. «stoli, stoli e tepëruar; të mbajturit më të madh, kreni», *njeri me sqimë*; *sqimatár*, fem. *sqimatare* (Çekrezi, *sqimtar*) «që ka qejf të niset e të stoliset e të vishet mirë», *i, e sqimët* «sqimtar, sqimtare»; Cordignano ka dhe verbin *me u sqimue*. Si e pa G. Meyeri 388 (e më parë Kamarda I 69), vjen prej gr. *σχῆμα* «qëndrim, çehre, formë, figurë», poashtu si sllav e vj. kishtare *skima* «petk murgu» e rum. *schimă* «qëndrim, petk». Me të drejtë Kamarda (I 344) ka vënë re se trajta *simë* me ruajtjen e spirantit tregon se është një huazim më i ri prej greqishtes.

Fjalë e mbarë gjuhës. Del që te Budi (DC 50, 179b, 181b, SC 20): *en gjithë sqimash e madhështish, e begatishi cë pādëreja*; *Ndë sqimë e ndë madhështi*; *E ata trima sqimatarë, Të shpejtëtë si rrufë*; *për denarë e për pagëtyrë, o veçësë për sqime e për madhështi*. Përdoret edhe sot në Shqipëri të mesme, kështu në Shën Gjergj të Tiranës *grue sqimatare*. Si fjalë edhe e gegërishtes, pas kriterëve që vendosi Thumbi (IF 26,10), *sqimë* duhet marrë si një huazim mjaft i vjetër në shqipen, mbase jo prej greq. së re, po prej së mesmes. Në këtë vështrim dëshmon dhe përhapja e fjalës greke në sllav. e vj. kishtare e në rumanishten. Më anë tjetër moskalimi i së-së në *sh* dëfton që *sqimë* bën pjesë në ato huazime të cilat pas konstati-meve të Joklit (Slavia XIII 292) kanë hyrë në periodën shekulli i VII. gjer shekulli i XI i erës sonë. Huazim i periodës bizantine, i sferës sociale e i kozmetikës.

sqitës m. «krehër». Këtë fjalë të shqipes së Greqisë (te Reinholdi 27) G. Meyeri më parë (f. 228) e bashkonte me *qis qit*, në Greqi *shqinj shqita*, të cilën e nxirte pa të drejtë prej lat. *excitare*. Më vonë (AS V 101) e zëbërthen në *s-qitës*, ku *s-* sipas tij = lat. *dis-*, e *qitës* nga një **qidtës*, e afër brenda shqipes me *qij*, kuptimi i parë «çaj», më tej me gr. *σχίζω* «çaj, veçoj» lat. *scindo* «gërric, gris, shkyej, çaj» etj.

Kjo fjalë dialektore nuk paraqet asgjë të vjetër. Është një nomen agentis me *-ës*, një postverbal *i shqit* «ndaj një gjë që ka qenë e ngjitur; këput një copë nga një e tërë», që është opoziti i *ngjit*. Ndrimi i *sh-së* në *s* në ballë të fjalës çfaqet nëpër dialektet e shqipes, khs. Jokl LKU 101, prej kolonive kal. *spërvjër* «perde; çadër»: *vjer*, me *spër-* për të përgjithshmen *shpër-*. Këtë spjegim e vërteton tani fjala *çitës* m. «krehëri me dhëmbë të rrallë, që përdoret për të shqitur flokët» në Breg të Detit (Nivicë-Bubar, M. Totoni), e cila ka dalë nga *çit*, trajtë dialektore e fjalës *shqit*. *sqitës* e

çitës janë variantet e një fjale të vetme. Përbëjnë një nga konkordancat e shqipes së Greqisë me tosk. jugore.

sqotë f. «borë përzier me shi; erë me shi, erë që shtie shi nëpër dritare e dyer; borë e imtë, borimë». G. Meyeri 388 jep prej Kalabrie e Sicilie kuptimin «shtërgatë, furtunë», prej Toskërie trajtën *cqotë* «borë me shi përzier», dhe e lë fjalën të paspieguar. Sikundër e pa Vasmeri (Studien I 56v.), vjen nga sllav. *slotā* «shi përzier me borë», sllav. e vj. kishtarë «hiems», me epentezë të një *-k-*je në grupin *-sl-*, si te *shklā shqā* nga lat. *sclavus*: sllav. e vj. kishtarë *slovenin*, etj. Pranuar dhe te Jokli (IJ XIV VII 169). Mungon çuditërisht te Seliščevi.

Formë kryesisht e toskërishtes, që si e tillë rrjedh nga bullgarishtja. Prej Veriu i përgjigjet *skllotë* «tufan bore, llohë; stuhi» me rrjedhojën *skllotinë* f. «shi e borë bashkë, llohë», te Cordignano (për Kosovë) «neve mite che cade a fiocchi larghi e non fa presa», *ka ra nji skllotë bore*, te Gazzulli *skllot m.* «undajë, mrac (= qull i trashë), lat. *iusculum*; skot», *skllotinë* «shi e borë bashkë, *skllotinë bore* «kur bora shkrihet.» Kjo formë, si e geg. veriore që është, rrjedh prej serbokroatishtes. Nga pikëpamja e një kronologjie relative *skllotë* është më e re se *sqotë*, meqë te kjo grupi *kl* është asimiluar në *q*, te ajo përkundrazi mbeti e paasimiluar, dhe bile likuida *l* u velarizua në *ll*. Ndërkaq edhe *sqotë* me *-s-*në e saj të pandryshuar në *sh* shihet se nuk bën pjesë në më të vjetrat huazime sllave të shqipes. Në këto hyn përkundrazi trajta *shqotë* e kësaj fjale. Edhe *shllotë* «shi e borë bashkë» që jep Cordignano për Dukagjin, pas këtij kriteri duhet të jetë më e vjetër se *skllotë*. Raporti fonetik midis *skllotë* e *sqotë* është poai që vrehet te *kllapë*: *qapë*, *glinë*: *gjinë*. — Shqipja ka nga sllavishtja dhe të tjera huazime të kësaj sferë, si *llohë*.

squfur m.; *i squfurt* «prej squfuri». Për këtë fjalë G. Meyeri (f. 411, AS IV 54) nisat nga *shqufur* — duke parë te *squfur* një trajtë gabim — dhe *shqufur*, nga një **shklufur*, bashkë me arom. *sclifur* «squfur», e nxjerr nga një bazë latine e rindërtuar **s(c)lufurem*; geg. *surfull* me variantet e saj, bashkë me rum. *sulfur*, sipas tij është një fjalë librash, prej lat. *sulfur*. Spiegimi i arom. *sclifur* pranohet te Pušcariu EW 1554, ai i *squfur*-it te Vasmeri Studien I 56. Khs. dhe Weigand 78, Meyer-Lübke REW 8443. Po tani Papahagi 958 fjalën aromune e jep me trajtën *skifurā* dhe e bie të ardhur prej shq. *squfur*.

Trajta *squfur* *cqufur* është e dialekteve të toskërishtes. Aty dhe *i squfurt* e verbi *squfurós*. Nuk është trajtë e gabuar, si mendonte G. Meyeri. Reflektimi i *s-*së me *s-* tregon qartë se s'kemi të bëjmë me një huazim latin të vjetër e të drejtpërdejtë. Baza latine **s(c)lufur* menduar prej G. Meyerit mund të jetë e drejtë, po ajo do zbritur në kohën mesjetare. Squfuri është një objekt importuar vazhdimisht prej Italie, i cili në perioda të ndryshme hyri dhe me emra të ndryshme. Prandaj kemi të bëjmë me një huazim nga lat. mesjetare. Poandëj rrjedh geg. *surfull* (me verbin *surfulloj*), po kjo prej lat. *sulfur*, e cila pësoi një metatezë në gjuhën shqipe, duke u venduar te fjalët më *-ull*. Trajta *sulfër(ë)* e Budit (*flaka e zjarmit e e sulfërit* SC 317) e *sulfurë* e Bardhit (f. 166) dhe e Bogdanit (I 167) mund të jetë letrare, ashtu si mendon dhe G. Meyeri. Për *sumpur-in* e Borgo Erizzos sh. Tagliavinin 248.

step m. «thep, majë». G. Meyeri 427 anon nga mendimi që *step strep*, të cilën ai e gjen te Vreto me kuptimin «hundë shkëmbi, shkëmb i dalë», i përket fjalës *tepe tepé* «kodrinë, breg» që është me burim turk. Jokli për-

kundrazi (Balkangerm. u. German. im. Albanischen 125), duke e marrë fjalën prej Kristoforidhit, i cili e ka për *ή άκρα*, e afron brenda shqipes, me të drejtë, me *cep* «skanj; qoshe, kënd i dalë (i murit); sup; sqep; majë (shkëmbi a guri)» *cepoj* «godit, qëlloj» e me *thep* «majë e mprehtë e shkëmbit». Në këtë mes do të mendohet një metatezë *cep* (fonetikisht *tsep*) në *step*. Te *strep* ka zhvillim sekundar të një *r*-je pas *t*-së, mbase dhe me ndikim të ndonjë fjale tjetër, si *shkrep*.

sterrë «shumë i zi, i zi pisë». Del sëpari te Dozoni (në një këngë, f. 107): *vetë e bardhë e koka sterrë* «Toi mëme si blanche avec des cheveux si noirs». Pas G. Meyerit (f. 392) trajtë metateze, nga një **cerrë*, e kjo nga serbokr. *crn.* «i zi, e zezë». Mendim i pranuar te Jokli LKU 113, Sandfeldi 77, Selišçevi 279.

Përdoret zakonisht për qiellin, për motin, kur vrëret aq sa «nxihet». Është një me *sterrë* «sternë, saranxhë», tertium comparationis errësira e kësaj për atë që e shikon së larti. Prandaj thonë *u nxi* (qielli) *u bë sterrë*. Me të njëjtin kuptim përdoret edhe *pus-i*, në shprehje si *u nxi* (koha) *u bë pus*; *ishte errët pus* (FGS). Janë krahasime ekspresive të gjuhës popullore; khs. p.sh. edhe *i zi pisë i bardhë borë* etj. Ky spjegim i *sterre-s* gjen vërtetimin e tij dhe në të dhënat e gjeografisë dialektore: kjo fjalë puthitet nga përhapja e saj me *sterrë* «saranxhë», të dyja janë më fort të tosk. jugore.

stërqokë f. «Corvus monedula, zog i familjes së korbave», *stërqók* m. «mashkulli i stërqokës». Fjalë me etimologji të diskutuar. Stieri (Nr. 82) lëkundet midis një zbërthimi në *stër-qok* e një tjetri në *stër-q-ok*, e në punë të etimologjisë midis një krahasimi të pjesës rrënjore *-qok* me serbokr. *čavka*, çek. *kavka*, gr. e re (*καρρα)κάξα* «laraskë» etj. e një spjegimi të pjesës së parë *stër-* prej lat. *sturnus* e gr. *ψάρ* «shturë». Diefenbachu I 47 përmend një spjegim të Cihacut II 716. G. Meyeri 393 gjen aty një fjalë sllave, emrin e lejlekut, *strъkъ*, bullg. *strъkъ* *strъkъ* serbokr. *strk* etj., e këtij spjegimi i mbahet edhe Selišçevi 198. Weigandi 79 — afërsisht ashtu si Stieri — e zbërthen fjalën në *stër-qok*, ku *stër-* *strë-* është prefiksi i ditur e *qok* = *qokthi* i Bashkimit, kjo sipas tij prej bullg. *čafka* «stërqokë». Jokli në të parë (Indogerm. Anzeiger 35, 37) e miraton në parim këtë analizë, veçse ai për arsye fonetike s'pajtohet me spjegimin e pjesës *-qok(ë)* nga fjala bullgare dhe sheh te kjo më fort një formim onomatopeik. Më vonë (Slavia XIII 613v.) e zbërthen fjalën në *stërq-ok*, duke gjetur aty një zgjerim me *-ok* të verbit *stërklas* «stërpik», një emërtim të këtij zogu nga pikat në pendët e tij, e fonetikisht një asimilim të grupit *kl* në *q*. Xhuvani-Çabej (BSS 4, 1956, f. 95) i mbahen, me rezervë, etimologjisë së Weigandit.

Që spjegimi nga sllav. *strъk* nuk qëndron, as nga ana e formës as nga e kuptimit, ka vënë në dukje me të drejtë Weigandi. E përforcon pastaj sidomos Jokli, duke vënë re ndër të tjera që fjala sllave ka hyrë në shqipen si *shtërk shtërgu* «lejlek». Ndërkaq edhe afrimi me *stërklas* nuk na duket i drejtë, kryesisht për arsye kuptimi: me *stërqokë* quhet vetëm *Corvus monedula*, jo dhe laraska; prandaj një emërtim i atij zogu të zi prej pikash ose larash objektivisht nuk është afër menç. Mbetet i drejtë zbërthimi në *stër-qokë* që patën bërë Stieri me Weigandin, po me kufizimin e Joklit, që d.m.th. te *qok qokë qokth* nuk ka vend për të kërkuar ndonjë bullg. *čafka*. Te pjesa e dytë e *stër-qok*-ut *stër-qokë-s* mendojmë se përmbahet *qok qokth* «Otus scops, gjon», po mbase edhe *qokë* «sqokë, squkë»; khs. për kuptimin rus. *klušā* «squkë; stërqokë; pulëbardhë, Larus», te Berneker I 521. Sido që të jetë burimi i fjalës, prej *qok*-ut a prej *qokë-s*, prefiksi *stër-* në të ka një kuptim përgjasimi, «zog si qoku (a si

qoka)». Vihet re ky kuptim dhe te *stërhell*, *stërkungull*, po sidomos te *stërbuf*, që përmban edhe ky një emër shpendi, si *stërqok*, *stërqokë*. Për këtë funksion të prefiksit khs. Xhuvani-Çabej në vendin e cituar.

suferinë f. «erë e fortë; erë e fortë me shi; erë e hollë». G. Meyeri 395 e jep me trajtat *sufarinë* e *fufarinë*, me kuptimin «shtëngatë me shi» dhe bashkë me *sufull* «gajdë» e me kal. (te de Rada) *shufëlmë* «fishkëllues» e *shufël'inj* «mormorare» e nxjerr nga it. *zufolare* «me fishkëllue». Pranuar te Helbigu 92, i cili ndërkaq ndrimin e it. *z* në *s* e spiegjon me anën e një asimilimi ndaj *f*-së.

Fjalë e toskërishtes, e cila te *-inë* paraqet një formant relativisht të ri, sikundër tregon *-n*-ja e parotacizuar. Brenda këtij dialekti fjala paraqitet me trajta e kuptime të ndryshme: Gjirokastra *sufërinë* «erë e hollë», Lunxhëria *suferinë* «erë me shi të hollë», Peshtani i Tepelenës «erë e fortë, erë mali», Vlora «erë e fortë». Është vështirë të ndahet ky emër ere nga geg. veriore *me sufrue* «me shti në vesh ndonji fjalë për mirë a për keq, me frymzue, gjerm. *einflößen*, *einflüstern*, it. *inspirare*, *infondere*, *suggerire*», *sufrues* «kush sufron», *sufrim* m. «të shtimë fjalë në vesh, *Einflüsterung*, *suggerimento*, *insinuazione*» që jep Gazulli për Mirditë. Analiza e mëtejme mbetet e pasigurtë. *fufarinë* pas gjithë gjasësh është formim onomatopeik, khs. në Gjirokastër i *frin* zjarit *fufufu*, në të folët e jevgve t'atij qyteti *shi e zborë le të bjerë*, *fufufuja mos të frijë*, me kuptimin e një ere të fortë. Mbase dhe *suferinë* është në thelb një formim i këtillë, gjithashtu edhe *shufël'më shufël'inj* e arbërishtes së Kalabrisë.

sukull m. «rreckë e mbledhur tutël, që shërben për të fshirë; shuk, xhumbë (te një ëmbëlsirë si hallva); rjetë ngjalash»; *sukuj vdore* «flokë të mëdhenj të borës». Fjalë e gegërishtes, që s'e ka G. Meyeri. Kristoforidhi e jep për Tiranë me kuptimin «*ρῶκος*, leckë»; Junggu e ka për «taccone, straccio», Bashkimi për «straccio di panno», Cordignano për «straccio, cencio», shumësin *sukuj*-t Gazulli (për Dukagjin) me kuptimin «rrex opange, këputë e indueme me shijë të mirë»; verbën *sukulló*j Bashkimi me Cordignanon për «stracciare, involgere alla rinfusa», FGS *sukulló*j «bëj sukull; pështjell; (figurshëm) marr nëpër këmbë», *sukullár*, fem. *sukullare* «rreckaman, zhelan».

Në pikëpamje etimologjike Jokli (Ungar. Jahrbücher VII 82) e bashkon pnbrenda shqipes me *cukël* pl. *cukla* «fundërri e leshit; send i vogël e pa vleftë; pakicë, pakicë teshash», te Bashkimi «poca roba, piccolo carico» e më tej eventualisht me *cule* «sarcinae, thes plot me drithë». Nuk duhet të jetë tjetër gjë veçse serbokr. *sukno* bullg. *suknó* «zhgun, shajak, cohë», duke u zëvendësuar silaba e fundit *-no* me sufiks *-ull*-. Fjala sllave prej bullgarishtes ka hyrë dhe në rumanishten: *sucnă* «fustan grash», sh. Dieffenbach I 249 v.

sulem «hidhem përmbi një tjetër, i lëshohem, i turrem, e mësyj»; *vër-sulem* «sulem»; *sulm* m., *sulmë* f. Fjalë me etimologji të diskutuar. Afrimin që bën G. Meyeri (f. 395, AS III 77) me sllav. e vj. kishtare *slati* «πέμπειν, me nisë, me dërgue», baza **kúljo* me kuptimin «vë në lëvizje», Pedersen (KZ 36, 338), e gjen krejt të pasigurtë. Me gjith'atë ky barazim paraqitet përsëri te Lidéni (Armen. Studien 77v.), me një formë më të zgjeruar, duke përfshirë, përveç fjalës së sllavishtes e të shqipes, dhe arm. *slanam* «*διοδεύσθαι, πέταμαι*, *sulem*, vrapoj, fluturoj». Me këtë formë e

miraton krahasimin edhe Jokli (LKU 49, Mélanges Pedersen 154 shënim); gjithashtu dhe N. v. Wijk (IF 24, 238), i cili shton ndërkaq dhe hol. *hollen* «me ecë trok, me ngarendë». Bariçi (I 94) e vendos fjalën te grupi ind. e vj. *cyávatē* «lëviz, ikën, largohet», gr. *σεύω* etj. (sh. për këtë më lart te *çoj*), po më vonë (Arhiv II 81) e bashkon përbrenda shqipes me *thëllëzë*, sh. dhe Glasnik Srpsk. Akad. 24 (1927) 41v. Një tjetër rrugë ndjek La Piana (Studi ling. alb. Varia 26), duke gjetur te *sulem* një intensiv të *sjell solla*.

Fjalë e mbarë gjuhës, meqë përveç gegërishtes e ka dhe çamërishtja bashkë me ligjërimet e kolonive: çam. e u vrësul «*και δραμών*» (Pouqueville, Voyage dans la Grèce III 303); në ishullin Hidra u sul të *mbin* «u sul ta mbystë» (G. Meyer AS V 40); te G. Dara prej Siqelie (Kënka e sprasme e Balës 34).

Neologjizëm, formuar prej *sulm*, është verbi *sulmoj* bashkë me emrin (nomen agentis) *sulmues sulmonjës*. — Nga etimologjitë e fjalës, spiegimi që jep La Piana me mjetet e brendshme të gjuhës është i vetmi i drejtë; të këtij mendimi jemi prej kohe edhe ne. Ky spiegim përlligjet dhe semantkisht, meqë *sjell* e *sillem* kanë dhe kuptime që afrohen me atë që ka *sulem*, si «i bie, e qëlloj», e që sëpari i vuri re Weigandi 78 («schlagen», mit Dativ «werfen nach»): *i sjell me gur* te FGS, *suell* «struck» te Haslucku (f. 12 shën. 2), në Poros të Greqisë e ashtu *zu thikënë me dorë të djathëtë e e hapi thikënë zervisht e me të gjithë fuqi i a suall ndë mes kursarit e e ndajti si karcavec kursarë* (G. Meyer AS V 35). Khs. dhe prej Buzukut (LXII/2, Jeremia 18, 20) *kur të sijellsh përmbi ta ushtërinë* «adduces enim super eos latronem repente» (pas serbokr. *vojsku*), prej Budit (DC 191b) *Pom drūt suoll e j rā*, prej Bogdanit (I 102, 23) e *tue mbetunë pak gjall së siellet së vet* «e restando semivivo dal proprio colpo». Për *sillem* khs. geg. *iu suell atë* «iu drejtua, iu mat» (me grushta, me ndonjë armë), te Haslucku 221 *sillem* «assassinat». Një i tillë zhvillim semantik vihet re dhe te disa sinonime të verbit *sjell*, siç janë *bie* e *kthej kthehem*: *bie* «sjell»: *i bie* «e rrah, e godit, e qëlloj», *i kthehem* «i sillem, i vërsulem». Prej gjuhësh së tjera khs. gr. *φέρωμαι* «i bie, i sillem me . . .»: *φέρω* «bie, sjell, bar», *φορά* «impetus»: *φέρω φέρομαι*, gjerm. *sich gegen jemand wenden*, frgj. *se diriger vers quelqu'un, diriger ses attaques contre quelqu'un*. Për nga ana e formës *sul-* qëndron ndaj *sjell* në lidhje apofonie; *sjell* nga një **kuel-*, *sul-* nga një **kuól-n-*, me liquida sonans që dha rregullisht *ul*. Raport apofonie i njëjtë me atë që vihet re te *pjerdh*: *purth-*. Mbetet problem pse te *përkul* që pas Joklit paraqet pokëtë shkallë apofonike të indoeur. **kuel-* kemi okluviz, e te *sul-* *sulem* spirant.

surmë (i) «i përhimë i mbyllët». Këtë fjalë, e cila mungon te G. Meyeri, Jokli (Mélanges Pedersen 153vv.) e afron përbrenda gjuhës me *i thjermë* «i përhimë» *i përthjermë* «si i përhimë», e jashta shqipes me lit. *širmas širvas* «i përhimë, i murmë», duke çuar *thjermë-n* te një bazë **k'ero-*, *surmë* te një **k'ormo-*. Etimologji e pranuar te Pokorny I 574, Cimochowski Li. Po. II 221.

Sufiksi *-më* është i shpeshtë në mbiemra ngjyrash, ku ka një kuptim përgjasimi, *i përhimë* «si në hi», *i zyrtë* (*zi*), *i bardhemë* etj., sh. Li. Po. VIII 108 shën. 75, Xhuvani-Çabej Prapashtesat 69. Kështu fjala do zbërthyer në *sur-më*, sikundër mendon edhe Jokli. Ndërkaq te kjo fjalë e geg. veriore kemi një huazim krahinor prej serbokr. *sur*, *-a*, *-o* «i murmë, i përhimë», sh. edhe Gazullin 381. Ky e jep për Malsi të Madhe, bashkë me varianten *i syrmë* «me gjithfarë nryjesh, gjerm. bunt, buntfarbig, it. vario-pinto» e me shprehjen *syra-syra* «me nryje gjithfarësh». Për etimologjinë*

e fjalës sllave (serbokr. e bullg.) khs. Mladenov 618. Ajo prej bullgarishtes ka hyrë dhe në rumanishten bashkë me aromunishten: rum. *sur*, në *cal sur* «kalë i përhimë», sh. dhe DLRM 824.

susák m. «Lagenaria vulgaris, lloj kungulli në trajtë shisheje, që përdoret për të mbajtur ujë, kungull ujës». Fjalë e Shqipërisë së mesme, mungon te G. Meyeri. Prej turq. *susak* «i pavaditur, i thatë».

sutë f. «drenushë». Mungon në këte formë te G. Meyeri, i cili (f. 420, te *shut*) jep vetëm *shutë* «drenushë». Del që te Buzuku (LXXXVII = LXXXXVII, Kënga e këngëvet 2, 9): *porsi kaprolli o mangu i sutësë* «similis . . . capreae, hinnuloque cervorum». Bardhi Cervus *Drë*, *Cerva Suta*. Bogdani (II 12,5) *Na të ligatë suta, qish tjetër jemi mbijse një rëmbim* «Imbelles Damae quid nisi praeda sumus», poaty *Zana si një sut'e naltë*. Është femërorja supletive e *drë(r)*-it, ashtu siç është *drenusha* femërorja e mocionit të tij. Në lëmë të shqipes *suta* është simboli i butësisë së karakterit, prandaj me *sutë* e *si sutë* cilësohet dhe një vajzë e butë e e urtë. Po është edhe simboli i hieshisë këmbëlehtë; khs. *Vasha breg, e breg ne breg, Breg ne breg kecen si suta* në një këngë të Ljarjes e Shestanit (D. Kurti HD XIV 92). Me këtë emër në Gegëri quhet dhe një lopë kur është rrumbullake e e mbushtë; e në fushën e besimeve popullore në Dukat të Vlorës *sutë* është një lloj zane që përfytyrohet si e madhe nga shtati e në trajtë të lopës. Edhe në të tjera gjuhë emrat e cervidëve e të gjedhërve ndrohen nganjëherë në mes të tyre; khs. për këtë sllav. *korva krava* «lopë» shq. *ka-u*: lat. *cervus*, kymr. (kelt.) *carw* «dre», e m'anë tjetër gjerm. *Hirschkuh* «drenushë», fjalë për fjalë «lopë dreri», te Jokli WuS XII 68v. Një tjetër figurë e demonologjisë popullore në Veri është kompoziti *dham-sutë* («me dhëmbë si të sutës»), te Cordignano «një lloj pelë e përrallave, e shurdhër, e cila kalonte male e dete me atë që donte të shpëtonte me ndihmë të saj, e mbi atë kaluar rrinte përherë *dhevështruesi*, e mëzi u vente pas» etj.; te Gazulli ka *dhambësutë* «një farë voskle (goskle), gjerm. Porzellanschnecke, Cypraea» (Malsia e Madhe). Nga fusha e onomastikës do shënuar se në Veri *Sutë* është edhe emër gruaje. Veçanërisht prej toponimisë le të përmendet *Livadhi i Sutave* në Iballe (A. Fishta HD VI 688) e *Maj' e Sutës* pranë Elbasanit (Gazetteer 177).

Për etimologjinë e fjalës do pasur parasysh që *sutë* në disa dialekte të gegërishtes shënon dhe kokëlakrën, *sutë laknash* te Junggu, Bashkimi e Busetti, *sutë lakne* te Gazulli, dhe që *sutaku i kresë* në Pukë po pas Gazullit është rrashta e kresë, kafka; aty në f. 382 ky autor jep dhe një *kap-sutë*, po pa i shënuar kuptimin. Nga një krahasim i *sutë lakne* e *sutë laknash* me emrat e kokëlakrës në disa të tjera gjuhë, si gjerm. *Kopfkohl* (*Kopf* «kokë, krye»), it. *cavolo cappuccio*, slloven. *glavâtica* «kokë lakër» (*glava* «kokë, krye», Berneker I 324) e me vetë termin botanik të kësaj bime *Brassica oleracea capitata* (*capitatus* «kryemadh»), shihet se *sutë* aty ka kuptimin «krye». Këndeje dhe për emrin e shtazës del «krye» si kuptim i parë, pra *suta* ka marrë emrin nga kryet e saj. Këta, sikundër dihet, e ka shyt, pa bri, e kjo cilësi çfaqet si element emërtimi edhe te një tjetër emër i drenushës *mitëz e kacamitë*, sh. te *mitë* II. e khs. dhe BUST Ser. Shk. Shoq. 4 (1962) 127 e 143, St. Alb. 1 (1964) 81, tani rishmë Rendic. Ist. Lomb. Cl. Lettere 99 (1965) 218. Për këtë arsye *sutë* në thelb është një me *shutë* «pa bri» (për kafshë femra) që njëkohësisht shënon vise-vise dhe *drenushën*, e pra një dhe me *shut shyt* «pa bri». Për etimologjinë e këtij grup

fjalësh sh. *shut shyt*. Si trajtë më e vjetër e *sutë-s* do të mendohet një **çut-*, ku afrikata pas një ligje fonetike të shqipes u zhvillua në *s*, si te *porosit*, *sorrë* etj.; sh. dhe Rev. Shkenc. e Inst. Pedag. dyvj. të Shkodrës 1 (1964) 18, Z. f. Balk. II 21. Kjo fazë e përparme e fjalës ruhet në rum. *ciut* «shyt» e *ciută* «sutë, drenushë» pranë *șut* «shyt», fjalë që shihet kështu se buron prej shqipes: khs. rum. *cioară*: shq. *sorrë*.

s̄y m. Fjalë me etimologji të diskutuar. G. Meyeri (f. 383v., AS III 79), duke sjellë këtë fjalë me gjithë rrjedhojat e saj *syth*, *syzi*, *sylárk* e *syqénëzë*, e bashkon me sllav. e vj. kishtare *sinpti* «me shkëlqye» *sinb* «i ndritur», duke menduar për një burim të *s-së* së shqipes prej një palatali *k'* të indoeuropianishtes. Pranuar te Brugmanni I² 102. Ndërsa Hirti (BB XXIV 263) e afron me got. *skeinán* «m'u dukë, me ndritë, me shkëlqye» gjerm. e lartë e vj. *scinan* gjerm. e sotme *scheinen*, Pedersen (KZ 36, 291 e 318vv.) e largon dhe nga kjo fjalë dhe nga sllav. *sinôti* dhe e afron me grupin e lit. *akis*, sllav dual *oči*, arm. pl. *açk'* «sy», duke menduar një afe-rezë të vokalit nistor, ashtu si në *dhi*, *tetë* etj. Ky afrim është pranuar nga shumë anë: te Jokli IF 36, 101, Walde-Pokorny I 170, Walde-Hofmann II 201, Pokorny I 776, Bariçi I 109 e Hymje 33, Tagliavini 248, Hofmanni GEW 242, Vasmeri REW II 626 e 630, po jepet me ? te Boisacqu 722 e nuk shënohet fare te Ernout-Meillet, e as te Fraenkeli. Wiedemanni BB XXVII 201 e afron me got. *hvetis* «i bardhë» lit. *szvidus* «i ndritur» ind. e vj. *çvin-date* «shkëlqen, ndrit». Një etimologji me mjete «alarodike» jep Oštiri Arhiv II 307v. Te baza indoeuropiane **k'eu-* **k'u-* e shpie *sy*-në La Piana (Intorno 32 shënim, SLA I 32, 72), duke e krahasuar, si refleks të një forme bazë **k'u-jo-m*, me ind. e vj. *śocati* «ndrit, shkëlqen, djeg».

Fjalë e mbarë gjuhës. Është një neutër i vjetër, sikundër shihet nga përdorimi i saj te Buzuku (IX/2, Psalm 53, 9; LXL/2, Mateu 20, 15): *e përmbi anëmiqt të mī pat qyrë sytë tem* «et super inimicos meos despexit oculus meus», *sytë tat anshtë të keq tash* «An oculus tuus nequam est...?» Kjo gjë pat qenë diktuar që te Pedersen (KZ 34, 290; 36, 320) — për punë të ndrimt të gjinisë në shumës —, mendim që vërtetohet tani më së miri me anë të Buzukut. Sikundër e kemi vënë re dhe te BUST 3 (1955) 40v., kalimi i disa emrave që shënojnë pjesë të trupit që janë çift, si *sy*, *vesh*, *gji* (ku duan shtuar edhe *gju* e *krah*), nga neutri në mashkullore, është kryer nga puna se këto në trajtën e tyre të shquarën më *-të* (*sytë*, *veshëtë*, *gjitë*, *krahëtë*, *gjutë*) më një anë ishin njësoj në njëjës e në shumës, më anë tjetër piqueshin me mashkulloret e shquara të shumësit, homonimi gramatikore që u mënjanua me anën e kalimit të tyre në mashkullore. Nga përdorimi që ka Bardhi (f. 65, 75 *mb s̄ysh*, *s̄y*, *plot me s̄y*) shihet vetëm gjatësia e vokalit, po asgjë për gjininë e emrit. Përveç rrjedhojavet e kompozitevet *syth*, *syzi*, *syzezë*, *sylárk*, *syqénëz* e *mës̄yj* që jep G. Meyeri (për *përsiás* sh. këtë fjalë), *sy* ka zhvilluar rreth vetes një grumbull fjalësh, për të cilat sh. sidomos FGS 512v. bashkë me Mannin 465vv. Nga këto, *syç* m. «frikë (*kam syç* «kam frikë» te Kristoforidhi) gjen të përmbajë sufiks -ç prej *-sh*; *syll* «vangosh» fem. *syllë*, që ka dhënë edhe verbin *syllit* «shikoj tërthori, me bisht të syrit», është një formim me *-ll*, *sytár* m. «shenjëtar, nishanxhi» me *-tar*, sh. për këto formante Xhuvani-Çabej Prapashtesat 29, 67, 88v. Me *sy* në kuptimin «gjir, shtjellje» (*syri i ujit*) lidhet *syenë* f. «vend i thellë në ujë; vend peshkimi», e cila sipas Gazullit është trajta e shumësit (njëjësi *s̄y syni*), dhe *-enë* besojmë se është marrë nga *buenë*, fjalë e afër nga kuptimi. Deminutivi *syzë* f., në gjuhën popullore shënon syrin e tryezës, që hapet me të tërhequr, sirtarin e një dollapi (*syza e dollapit*), edhe qelizën

a zgavrën e hojes së mjaltit, kuptime që piqen me ato që ka *göz* «sy» në turqishten, e cila ndër të tjera do të thotë dhe «cassetto; reparto in un armadio ecc., apertura, foro; cella», sh. Bonelli 117. Kuptimi «gjozlykë» që ka *syzë* sidomos në shumës (*syzet, syzat*) e që del sëpari te Junggu e te Kristoforidhi, është relativisht i ri. Ka më të gjarë të jetë një përkthim (calque linguistique) i it. *occhiali*, gjerm. *Augengläser*, turq. *gözlük* në gjuhën letrare se një fjalë e gurrës popullore. Të kësaj gurre janë ndërkaq verbet *përsysh* «marr më sysh», *mësyj* e *synoj*, sh. këto dy të fundit. Për kompozitin *sykath* m. khs. *kath*. Gazulli jep edhe emrin botanik *sykau* m. «*Taraxatum officinale*, lule dylli». Shprehjes *pata synë të* «pata qëllimin të» i përgjigjet rum. *ii e ochiul la plecare* arom. *ho-are ochiul trã plicare*, P. Papahagi XIV. Jahresber. d. Rum. Inst. Leipzig 122 e). M'anë tjetër *përsysh* gjen analogjinë e saj në gr e re **ματιάζω**

Etimologjitë e gjertanishme janë nisur nga mendimi — i natyrshëm në vetvete — që kjo fjalë ka qenë që në krye të herës emërtimi i organit të shikimit, e duke pasur këtë bindje, autorët e tyre janë përpjekur të kapërcenin vështirësitë që dalin aty në lidhje me formën e fjalës. Këto vështirësi, përsa i përket spjegimit të G. Meyerit e të Hirtit, janë vënë në dukje dhe më parë, ato përveç së tjerash nuk arrijnë të spjegojnë s-në e fjalës shqipe. Po në vështirësi të këtij lloji ndesh dhe spjegimi i *sy*-rit prej një indoeur. **okui-* nga ana e Pedersenit: sidomos *y* pas s-së, ku duhej të ishte një *i* në qoftë se s-ja reflekton labiovelarin indoeuropian, e pastaj karakteri nazal i vokalit. Për të mënjeluar këto vështirësi, dijetari danez detyrohet sëpari të mendojë-që trajta e hershme e fjalës ka qenë *si*, ku *i*-ja u labializua në *y* pranë s-së e *y*-ja u kthye përsëri në *i* në tosk. jugore ku kësaj fjale i thonë *si*; e së dyti që nazaliteti i *y*-së në gegërishten (*sy*) është sekundar, poashtu si në geg. *mî*. Këto paravendime janë jo vetëm të pavërtetueshme, po edhe jo bindëse. Kundra mendimit që trajta e parë e fjalës të ketë qenë *si* e që kjo të jetë labializuar në mbarë shqipen në *sy*, flet ndajfolja (e lidhëza) *si* «qysh», e cila nuk ka pësuar gjëkund një të tillë zhvillim. Edhe po të pranojmë me Pedersenin që kjo të ketë rrjedhur prej një baze **kuei-* e me këtë pra *i*-ja prej diftongut *ei*, ky monoftongim është aq i moçëm në gjuhën shqipe, sa labializimi i *i*-së në *y* duhej të kish përfshirë dhe këtë fjalë po të kish vepruar me të vërtetë te *sy* e të kish qenë me të vërtetë një e tillë prirje labializimi e shqipes në këtë pozicion. Për mendimin tonë *sy* është primare ndaj *si* që në krye të herës; gjithashtu primar është karakteri nazal i vokalit, sikundër e tregon dhe denominativi *synoj*. — Etimologjia e La Pianës qëndron edhe bie me rregullën fonetike të G. Meyerit që palatali indoeur. *k'* ka dhënë në shqipen dhe *s*, rregull që dihet se pas tronditjes që ka pësuar nuk mund të thuhet se është shpresa që të përtërihet.

Për mendimin tonë *sý syni*, si refleksi i një baze **syn* e kjo i një më të lashte **sün-*, përbën një konkordancë parciale me emrin e diellit në gjuhët gjermanike got. *sunno*, *sunnin*, nord. e vj. e gjerm. e lartë e vj. *sunna*, të cilën e krahasojnë vetëm me fjalën iranike av. *xv ng* «dielli» *xvanvant* «plot me diell», sh. Walde-Pokorny II 447, Kluge-Goetze 569, Pokorny I 881v. Largimi kuptimor që ka pësuar kjo fjalë indoeuropiane në shqipen gjen analogjinë e tij në irl. e vj. *súil* «sy» që e afrojnë përgjithësisht me grupin gr. **ἥλιος** lat. *sól*, got. *sauil* lit. *sáule* «diell»; bie në *sy* në këtë mes dhe shprehja shqip *sy dielli*, në betimin për atë *sy dielli*, tosk. jugore (Libohova) për atë *sin' e diellit*, që nuk mund të ketë tjetër kuptim veçse «diell». Në pikëpamje morfologjike fakti që *sy* në shqipen është një neutër i vjetër pajton më së miri me gjininë neutre të fjalës në gotishten, *sunnin*, pranë fem. *sunno*. Në pikëpamje fonetike një spjegim kërkon reflektimi i

s-së indoeuropiane me *s-* në pozicion para një *u-*je të gjatë te baza **sūn-* që dha *sý*. Në pajtim me një rregull të ditur të Pedersenit (KZ 36, 277vv.) mendohet pothuajse përgjithësisht që kjo *s* në atë pozicion ka dhënë *h* në shqipen, në fjalë si *hyll yll* e *kohë*. Po **sūn-* : *sý* hyn në ato fjalë, në të cilat *s-*ja u ruajt ose u zhvillua në pozicion përpara *u-së*, edhe kur ajo paraqet refleksin e një palatali ose të një labiovelari indoeuropian, si te *sup* e *sulem*. Për mendimin tonë *sy* është një nga ato fjalë, të cilat janë caktuar të japin një ndihmëse në rishikimin e çështjes së reflekseve të *s-së* indoeuropiane në gjuhën shqipe. Kjo çështje mbetet një problem edhe pas trajtimevet të mëparme (G. Meyer AS III 45, Brugmann I² 756, Pedersen KZ 36, 277vv.) dhe pas atyre të fundit (Pisani Revue des Et. indo-eur. IV, 1947, f. 5vv.; Mann Language 28, 1952, 39v.). — Gjatësia e *u-së* është ruajtur te *y-ja* e fjalës shqipe, të cilën prandaj shkrimtarët e vjetër të Veriut e shkruajnë me vokal dyfish *sy*, e arbëreshët e Italisë *sii*. — Sh. dhe *sivonë*.

synoj «e kam synë te një gjë dhe përpiqem t'ja arrij qëllimit, kam qëllimin (të bëj një gjë)». Mungon te G. Meyeri. Fjalë e gurrave popullore. Del sëpari te Bashkimi, me trajtën *m'u sýnue* «m'u vū sý më sý, it. abbocarsi». Logoreci ka *me synue* «me shikjue me kujdes, me beft ndokend për të mira e hijeshi qi ka në vetvedi» e si sinonim të *me nderue*, K. Gurakuqi (Illyria I Nr. 5 f. 8) e dëshmon për të folët e Malësisë pa një ubikacion më të saktë. Gazulli jep për të folët e Pukës aktivin *me synue* (për Mirditë *me senuë*, nëpër shkallën *me sinue*, me ndrimin *y : i : e*) «me pasë qëllimin, menden, kam *synue* me *shkue*, si pasiv — poashtu si Bashkimi — *m'u synue* «m'u pa me sy», e me objekt dativ *me i synue jetën kuj* «attendere alla vita di qualcuno». Ky autor jep për Malsi të Madhe dhe kompozitin më *ndër- me ndërsynue* «me qitë para sysh, me vū para sysh, me vu vis-à-vis», *kur të ndërsynohemi në Shkodër tash shofim*, si dhe me kuptimin «me çfaqë, me qitë përpara, gjerm. vorstellen, darstellen, schildern, it. rappresentare», e kompozitin tjetër më *për- me përsynue*, 1. në *me përsynue një send* «me pasë qëllim m'e bâ, m'e vū për sy, gjerm. aufs Korn nehmen, it. prendere di mira, 2. «me qitë para sysh, me ndërsynue», 3. «me krahasue, gjerm. gegenüberstellen, vergleichen». Sikundër u shënua dhe më lart (*te mësyj*), *synoj* bashkë me kompozitet e saj *ndërsynoj* e *përsynoj* e me *mësyj* është një verb denominativ i *sy-r-it*, si të thuash «i vë syrin, marr në sy, kam synë të». Në formimin e saj si një rrjedhojë e këtij emri, *synoj* gjen analogjinë më të plotë të rum. *ochiese* «*synoj*» (*ochiu* «*sy*»), poashtu si shprehja *pata synë të* «pata qëllimin të» në rum. *îi e ochiul la plecare*, arom. *ho-are ociul trã plicare* te P. Papahagi XIV. Jahresber. d. Rum. Inst. Leipzig 122 e); khs. dhe *e mora ndër sy*; rum. *a lua la ochiu*, po edhe gjerm. *ins Auge fassen*. Prej gjuhësh së tjera khs. gjerm. *Absicht* «qëllim»: *absehen* «me *synue*, me ja mësy», kjo prej *sehen* «me pa», *frgj. viser* «me *synue*» nga lat. *visare* «me këqyrë me vemendje», it. *mirare* «me *synue*» nga lat. *mirare* «me shikue», gr. *σκοπέω* «vë re» e «*synoj*» etj.

sysk *syk*, fem. *syskë* *sykë* «për bagëti që kanë nga një rreth të zi përreth syve dhe njollatë zeza në turi»: *ka sysk o syk, dash sysk; dele, dhi syskë, o sykë*. Ka mbetur e paspieguar te G. Meyeri 484, i cili kufizohet te shënimi që *sysk* do ndarë nga *i zi*, e *zezë*, e *zeshkë* etj.

Fjalë e mbarë gjuhës, po me forma të ndryshme nëpër dialekte. Në toskërishten mbizotëron *sysk* (tosk. jugore *sisk*), në gegërishten (sidomos veriore) *syk* me rrjedhojat e veta. Për toskërishten Mitkoja 225 jep *syskë* «*ἡ ἔχουσα μαῦρα μάτια καὶ μαῦρα ὄφθαλμοὶ ἐπὶ ἀνθρώπων καὶ ζώων*». Pedersen 191 *sisk* «rötlich um die Augen», *siskul*

«ein so gefärbtes Tier (Schaf)» për Lëkurës të Sarandës. Prej Veriu Junggu sjell *syk-a* «pecora con muso bianco», Bashkimi *sykë* «pecora con muso nero», i (e) *sykun* «montone o pecora bianchi con muso nero»; Cordignano i *sykun*, i *syktë* «grigio (Dibra, Mati etc.): (lopës bojë hinit me pika të zeza përmbi sÿ, i thohet lopë e syktë. Ashtu dhent e syktë kur ta kën turinin me pika të zeza»; Gazulli i *sykëm*, e *sykme* «i larmë, it. variopinto me njeje të kuqëlme të përzieme me të bardhë e të zezë»: *ká i sykëm*, *sykë* «emën lope. Trajta *sykë* dhe te A. Sirdani (HD XIII 476, sh. dhe Leka X 409), *ogjëat sykana* te Leka IV 24 (Shkrel). Trajtës geg. i *sykun*, formuar analogjikisht pas participeve më *-un*, prej toskërishtes i përgjigjet i *sykur*, të cilën e gjejmë të Manni. Kjo bashkë me *sikul*-in e Pedersenit dëshmon për ekzistencën e trajtës *syk-* edhe në toskërishten.

Morfologjikisht si *sysk* si *syk* janë zgjerime të fjalës *sy*, e para me *-sk*, e dyta me *-k*, femëroret më *-skë* e *-kë*. Formanti *-sk* është shpesh pikërisht në emërtime të shtazëve: *ka brisk*, *dele briskë (bri)*; *gjel larisk*, *pulë lariskë (larë)*, khs. dhe *laraskë*. Poaty përdoret në disa rasa dhe *-k*, formant paralel me *-sk*, me të cilin ndrohet dhe në të njëjtat fjalë, si *sysk*: *syk*, *larisk*: *larik*, *sylark*, Xhuvani-Çabej Prapashtesat 63,83. Nga pikëpamja interne e shqipes ky spjegim etimologjik i *sysk*-ut gjen vërtetimin e tij në faktin që atje ku-si në tosk. jugore-syrit i thonë *si*, këto lloj bagëti quhen *sisk* e fem. *siskë*. Nga pikëpamja e ballkanistikës do shënuar se emërtimi i bagëtisë turizezë nga emri i syrit është një sajim i gjuhës baritore, që i kapërcen caqet e shqipes. Sidomos afrohet me *sysk syk* si një formim paralel rum. *oachësh* arom. *oaclicu* «i zeshkët» (*ochiu* «sy»), të cilën Puçariu EW 1217 jo aq mirë e krahason me shq. *sy-zi*. Një tjetër formë e rumanishtes është *oachin oacăn* e *oacăr*, nga e cila rrjedh edhe shqipja tosk. *vakër* «dele a dash me faqe e me këmbë të zeza». Edhe ajo shihet se buron brenda rumanishtes nga *ochiu oach-* «sy»; në këto rrethana nuk ka vend për një bazë latine **obaquilus* që ndërton Densusianu (Grai și Suflet VI 317) me pëlqim dhe të Candreas (poaty III 291) e të DLRM 551. Poashtu edhe arom. *oaclicu* bashkë me *oacarnu* «mouton blanc à la tête et (aux pieds) noire (noires)» mendojmë se spjegohen më drejt me mjetet e brendshme të atij dialekti (nga *ocliu* «sy») sesa me ndikime të jashtme, si anon të mendojë Papahagi 801. Në këtë lloj emërtimi të bagëtisë nga syri përveç shqipes e rumanishtes merr pjesë edhe greqishtja e re; khs. *ματ ύλλτο μα τούλλου* «të çdo farë ngjyre, me përjashtim të së zezës, e me një rreth të zi përreth syve» (për qe e për lopë), të cilën G. Meyeri (IF 6, 112) me të drejtë e lidh me *ματτ* «sy». Duke qenë e Epirit, kjo fjalë e greqishtes ka të ngjarë që të jetë sajuar nën ndikim të *sysk*-ut të shqipes, si një calque linguistique i këtij. Shqipja ka ndikuar në greqishten në mjaft fjalë të jetës baritore. — Do shënuar më në fund se në rasat ku *sysk syskë* përdoret edhe për njerëz (Ç'ke, *moj syskë, që po trëmbë? folna, moj, për kokë tënde*, Mitko 73), kemi të bëjmë me një kalim nga sfera shtazore të njeriu, pas gjase nëpërmes të poezisë popullore (sh. dhe *kalësh, e kolme*).

Résumé

ETUDES D'ETYMOLOGIE ALBANAISE XIX

Rr

rrëshirë rrëshinë f. «résine». Comme on sait, du lat. *resina*, continué aussi en roumain. Conçu dans le sentiment linguistique comme une formation à préfixe *rrë-*, ce mot a abouti à son tour aux guègues *shindërr* et *shinë* et au tosqe *shirë*.

rrëvitem (albanais de Grèce) «être jeté, se rapporter à quelque chose». Pas un mot des sources autochtones, apparenté au vieux sl. *vresti* et à l'all. *werfe* (H. Barić), mais le même que *vërvitem* «l'élancer», conçu comme *vërvitem*.

rrfatë f. : v. *furatë*.

rruell m. : v. *rryell*.

rrjesht, rresht m. «rangée, rang, file» Non pas du lat. *regestum regesta* «registre, catalogue» (G. Meyer), mais plutôt du lat. *restis* «corde, câble» (N. Jokl). Ce n'est à retenir la dérivation du turc *erişte* «espèce de vermicelles» soutenue récemment par M. R. Bernard.

rrnok m. «petite île; pièce de terre flottant sur l'eau». Peut-être d'un **ran-ok*, un diminutif en *-ok* de *ranë* «sable».

rrobull m. «*Pinus leucodermis*», *rr. i bardhë* «P. peuce, Pin des Balkans». Du lat. *robur* «chêne rouvre, robre». De l'albanais proviennent probablement l'aroum. *arobul robul* «pesse; sorte de sapin» et néo-gr. *ρόμβουλο -ή άγρία πεύκη* (T. Papahagi).

rrodhe f. «glouteron». Non pas d'un lat. **cardella* (de *carduus*) nulle part attesté (G. Meyer), mais à rattacher, avec N. Jokl, à l'albanais *rruaj* «raser». Le substantif ne représente pas pourtant le reflet d'une base indoeur. **rēd-*, mais plutôt un dérivé à suffixe *-dh -dhe* de l'ancienne forme à *-o-* de ce verbe.

rrojbë, rrolbë f. «*Carthamus tinctorius*, carthame bâtard» (tout aussi *Rubia tinctorum*, garance?), aussi *rrojbëz*. C'est un emprunt — resté inaperçu jusque-là — au lat. *rubia* «garance». Par sa forme le mot albanais se rapproche au roumain *roibă* et au portugais *ruiva*, mais par rapport à la voyelle interne (*o*) plus particulièrement au roumain.

rrozgë f. «fourré, taillis; ramilles emportées par un fleuve; épines des haies». Pour des raisons sémantiques, un emprunt du sl. *rozga* «rameau; beguette, etc. (G. Meyer) plutôt qu'un mot hérité, apparenté à *rrodhe* «glouteron» (N. Jokl).

rruaj rruej «raser». L'origine autochtone de ce mot, son appartenace au groupe du lat. *radere*, soutenue par N. Jokl contre les étymologies latines de G. Meyer et G. Weigand (*radere; rodere + radere*) est plus persuasive plutôt pour des raisons du sens que de la forme.

rrush m. «raisin». Non pas un mot du groupe de l'anc. ind. *rasā* «raisin» perse *raz razan* kourde *rez* «vigne; raisin», ni un emprunt du sl. *grozdr* (G. Meyer), mais un ancien élément de source pré-indoeuropéenne, apparenté au gr. *ράξ ραγός ρωξ ρωγός* «grain de raisin», comme l'avait deviné Camarda. Premier sens «baie». Forme de base **ragus-* ou **ragusj-*, à laquelle remontent, en outre, *Ragusa* en Sicile et *Ragusa* en Dalmatie, ce dernier nom dans P. Bogdani (1683) *Rushë* et *Rush*.

rruvâ m. «grappe à laquelle on a enlevé les raisins». Etant données

aussi les variantes *rrufane rrufâ*, c'est à rapprocher probablement de *rrë-fanë* «anse: queue d'un fruit, pétiole», et tous les deux mots a *vā vau* «gué au sens de «retourné, courbé».

rruvi f. «lingne, raie», *rruvjeshkull* f. même sens. Insoutenable l'origine d'un base présumée latine **rubescula*, de *ruber* «rouge» (G. Meyer). A préférer le rapprochement avec *vërrî* «petit sillon, raie, strie» envisagé par K. Kristoforidhi. Ce dernier mot se rattache pourtant à *varrë* «plaie; raie, rayure» *vara-vara* «rayé» (d'une étoffe), d'ou proviennent en outre *vurratë* et *vrragë*.

rruzullim m. «univers.» Comme l'a remarqué G. Weigand, de *rruzull* m. «sphère; globe». Ceci représente une dérivation en *-ull* de *rruzë ruazë* «perle». Autres désignations de l'univers en albanais *rrethi i shekullit* (P. Budi), comparable à l'all. *Weltkreis*, puis *gjithësi* f. (*gjithë* «tout, tous»), en albanais de Calabre *gjithsës* «all' universo».

rryej : v. *rienj*.

rryell m. «euphorbe». Ne remonte ni à un lat. **aliellum* (G. Meyer) ni à un **aliolum* (H. Pedersen), reconstruites sur *alium* «ail», qui auraient donné tout autre chose en albanais.

rryp, *rrip* m. «courroie», *rryp toke* «bande de terre». Comme l'a bien remarqué Hahn (p. 110), appartient à *rjep* «écorcher». Réduction de *je* à *i* comme dans *pjek* : *pikë*, *sjell* : *sillë*, *shtjell* : *shtill*, etc., d'ou résulte le caractère primaire de *rrip* face à *rryp*.

S

s «ne pas, ne». Constaté par F. Bopp comme deuxième élément de *as* «pas, pas même» et de *mos* «ne pas; est ce que ne», ce mot a été ramené par G. Meyer au lat. *dis-*, par Pedersen par contre comparé à l'arm. *ç*, *oç* «ne, ne pas», par N. Jokl enfin rattaché, à l'intérieur de l'albanais, au groupe de *sa* «combien» si «comme, comment» *se* «queoi, que». La forme première est *së*, conservé en Italie et en Grèce, et en Albanie même dans *sëmunë sëmurë* «malade». Et la source en est *se* «quoi», passant des propositions interrogatives du type *ç'di unë?* «qu'en sais-je? à celles de négation Cfr. pour cela le néo-gr. *τίποτε* «rien», issu de *τίποτε* «quoi donc?»

*salikó*j «ensevelir», *salikim* m. «funérailles», dans P. Budi *psalikónj*, *psalikime*. Identique, au fond, à *psalój* «chanter (en église)», *psaltir* «psaume», etc., empruntés du néo-gr. *ψάλλω*; mais, en tant que mot du guègue septentrional, de par l'intermédiaire de l'it. *salmo salmodia salmodiare*.

sanëp m. «moutarde». Revient une seule fois dans Gj. Buzuku. Remonte à l'anc. it. *sanapa*, tout aussi comme *fjalë sarpe* «mot âpre, mordant» du tosqe, dont le *n* a subi le rhotacisme.

sefërgjën m. basilic». Comme nous enseigne G. Meyer, du turc *fesleken*, emprunté à son tour au néo-gr. *βασιλικόν*. Le mot turc présente une grande richesse de formes en albanais.

sembër, *sëmbër* m. «laboureur qui partage l'attelage avec un autre; associé, copartageant de troupeaux». Mot des langues balkaniques et de l'Europe orientale, y compris le russe et le lituanien, dont l'origine est contestée. A retenu le fait que dans maints parlers albanais, du Nord aussi bien que du Sud, ce mot désigne également l'associé et la deuxième femme d'un même homme par rapport à l'autre, dite aussi *shemër*. Il s'agit donc probablement d'un seul mot, employé en deux formes et deux acceptations diverses.

send m. «chose, objet», *gjësendi* «quelque chose». Ni un emprunt au turc (C.H.Th. Reinhold, G. Meyer), ni le proche parent de l'anc. indien *sant-* «qui est bon», gr. ὄντ — «qui est, qui subsiste» (Ascoli, Camarda, Barić). Ce n'est que le pronom interrogatif *se* «quoi», substantivé et employé à l'accusatif, *sen*. Cfr. pour le développement d'un *d* final, *kënd*: *kë*, *kund* : *ku*. L'ancienne forme du mot nous est conservée dans Buzuku et Bogdani: *ndë gjithë sen* «in omnibus», *qi as njëseni nukë ka nevojë* «qui nullius eger rei» En albanais de Calabre *gjithsës* «all'universo», *të Gjithsës* «delle universe cose», *shum seja* «beaucoup de choses».

serotinë f. «rosée de soir ou de nuit». Mot du guègue septentrional, de l'it. *serotina* «tardive, du soir».

sëmbój: *më sëmbón* «j'ai des douleurs aiguës, mais courtes», au sens figuré «je me repens», *sëmbój* «toucher, léser». Ce n'est qu'une variation phonétique de *më cëmón* «j'ai des douleurs» (de coeur, etc.), déjà traité.

sëmurë sëmunë (i) «malade». Littéralement «impuissant» (*s mund*), ce mot atteste pour *s* une forme pleine *së*, et à travers le rhotacisme de *sëmurë* du tosqe, le caractère accessoire de *-d* dans le verbe *mund* «pouvoir».

sillë f. «petit déjeuner», *sellij* «déjeuner le matin». Rattaché à bon droit par H. Pedersen à *esëll* «à jeun» en tant que *e-sëll*, ce mot ne remonte pas, avec ce savant, à un indo-eur. **kuilo* **kuilā*, ni à un **a(u)sihlā* (gr. ἔως et anc. indien *usáh* «aurore»), mais représente un postverbal de *sjell* «porter, apporter, conduire», une forme à changement *je* : *i* comme *rryp rrip* : *rjep*, ci-dessus expliqué. A confronter pour le sens le lat. *ferculum* «plat» par rapport à *fero* «porter», le frç. *mets* du lat. *missus*, etc.

simahúer m. «complice, suppôt dans un meurtre ou une action de représaille». Comme nous enseigne N. Jokl, emprunt du gr. σύμματος d'époque byzantine.

sipër «en haut, dessus, au-dessus», *përsipër* «en-dessus, par-dessus», *i sipërm* «d'en haut, supérieur.» Ni apparenté au gr. ὑπέρο lat. *super supra* (Camarda), ni à analyser en *si-për* (G. Meyer; Pedersen), ni un emprunt au lat. *super* (A. Thumb). Il faut partir du composé *përsipër përsipëri* et concevoir cette forme comme *për s'ëpëri* «d'en haut». Cfr. pour la morphologie lat. *desuper*, frç. *dessus* de *de sus*, roum. *despre*, ceci à notre avis non pas du lat. *désuper*, mais du roum. *de* et *spre*.

sivonë «viso delicato, sembiante dolce», mot du poète G. de Rada de Calabre. N'est autre chose que *sinë* «l'oeil» (accusatif), où s'est introduit l'exclamation *-vo-* issue d'un *o*.

skanj skâj m. «bord, extrémité». Ni un proche parent de *kënd kand* «coin, angle» (G. Meyer) ni un emprunt du sl. *konσ* «but, commencement, coin», mais avec *skanjo* «chaise» le reflet de l'it. *scagno* «sellette».

skëtërrë f. «enfer». Forme à préfixe, *skë-terrë*, où le mot base est *terr* «obscurité». Revient dans *Skutër*, nom d'une localité à minières de charbon.

skundíll m. «ourlet, repli, frange». Pas le reflet d'un lat. reconstruit **cantile*, de *cantus* «bande de la jante» (G. Meyer), mais plutôt du sl. *skut* «pli, frange; giron» (Kristoforidhi). Ce mot a abouti, par l'épenthèse d'un *n'* à *skund*, ceci à son tour au pluriel **skundínj*, d'où par voie rétrograde, comme un pluriel singularisé, *skundíll*.

skutë f. «coin, angle; giron; refuge, cachette». Forme à préfixe, du sl. *kut* «coin, angle». Emprunt régional, dans le Nord au serbo-croate, dans les Sud au bulgare.

spikás spikát «faire saillie, sortir.» De l'it. *spicare*.

spithâr m. «petite fosse naturelle dans la montagne, qui sert de réservoir d'eau pour les hommes et le bétail». Forme à préfixe, du néo-gr. **πιθάρι** «cruche de terre, jarre».

sqeptore f. «bécasse». Avec *sqepç* même sens, une dérivation de *sqep* «bec», tout aussi comme it. *beccaccia* de *bec*, all. *Schnepfe* de *Schnabel*, etc.

sqerbul m. : v. *gërbulë*.

sqimë f. «parure, ornement; orgueil», *sqimatâr* fem. *sqimtare* «qui aime la parure», *me u sqimue* «s'orner, se parer». Comme il est notoire depuis longtemps, du gr. **σχῆμα** «forme, figure, mine». Emprunt de l'époque byzantine (grec moderne ou moyen), comme l'atteste sa présence aussi dans les parlars du guègue, et en littérature chez P. Budi.

sqitës m. «peigne». Jugé de manières diverses pas G. Meyer (EW 228, AS V 101), ce mot résulte être un postverbal en *-ës* (nom d'agent) de *shqit* «séparer», et comme tel le proche parent de *çitës* «peigne aux dents grands et rares», mot rencontré dans la région méridionale de Bregu i Detit (Acroceraunes).

sqotë f. «neige mêlée à la pluie; vent pluvieux; neige fine». Comme l'a remarqué M. Vasmer, du sl. *slota* «neige mêlée à la pluie». Aussi *shqotë*, *skllotë* e *skllotinë*.

squfur m. «soufre». Plutôt que d'un ancien emprunt au latin, **shklufur* d'une base **s(c)lufurem* (G. Meyer), il s'agit d'après toutes les données d'un mot emprunté au latin médiéval, peut-être à la base reconstruite par G. Meyer. Au lat. *sulfur* de la même époque remonte la forme *surfull* du guègue, qui a subi pourtant une métathèse.

step m. «saillie d'un rocher», dans Kristoforidhi **-ἡ ἄκρα** Plutôt qu'au turc *tepe tepé* «colline» (G. Meyer) ce mot est à réunir, au dedans de l'albanais, à *cep* «coin, angle» (Jokl), qui a subi ici une métathèse.

sterrë «très-noir», du ciel «extrêmement obscur». Non pas du serbo-cr. *crn.* «noir», à travers un **cerrë* (G. Meyer), mais identique à *sterrë* «citerne». Même évolution de sens dans *pus* «puits», dans des phrases comme *ishte errët pus* «il était très obscur, ténébreux, noir».

stërqokë f. «Corvus monedula, choucas». Rattaché par G. Stier dans son élément *-qokë* au serb-cr. *čavka* et le néo-gr. **κοκιάξα** «pie», et dans son *stër-* au lat. *sturnus* gr. **ψάρο** «étourneau», ce mot est considéré d'origine slave par G. Meyer et A.M. Seliščev (*strrk strk* «cigogne»). N. Jokl l'a rapproché de *stërklás* «arroser, asperger». D'accord en principe avec l'analyse *stër-qokë* de (G. Stier et) G. Weigand, qui trouve dans le deuxième élément le mot *qokth* «hibou, duc», nous nous séparons de ce savant quant à l'origine slave de ce dernier nom d'oiseau, contestée aussi, et à juste raison, par N. Jokl. Par son analyse, *stërqokë stërqók* résulte donc être l'oiseau semblable au hibou (*qok*) ou à la poule couveuse (*qokë*).

suferinë f. «grand vent; vent pluvieux; brise». Plutôt que d'un reflet de l'it. *zufolare* «siffler, jouer de la flûte» (G. Meyer) il s'agit d'une onomatopée, tout aussi comme dans le proche parent du mot, *me sufrue* «souffler quelque chose à l'oreille de quelqu'un «avec ses dérivés *sufrues* et *sufrím*. Le même vaut pour *fufarinë* «tempête, orage».

sukull m. «haillon, chiffon, torchon». Plus probable qu'une parenté avec *cukël* pl. *cukla* «déchets de laine² et *cule* «sac plein de blé (Jokl) est un emprunt au sl. *sukno* «drap».

sulem «se précipiter. s'élancer; attaquer», *vërsulem* «s'élancer, se précipiter» *sulm m.* «assaut, attaque, impétuosité». Ni du groupe du vieux sl. *srlati πέμπειν* et de l'arm. *slanam διαδύσθαι, πέταμαι* (G. Meyer, E. Lidén), ni de celui de l'anc. inden *cyávātē* «se mettre en mouvement, s'en

soi, poursuivre, pousser en avant; faire jaillir» ou de l'alb. *thëllëzë* (Baric). Il s'agit d'une forme apophonique de *sjell* «porter, apporter, conduire» qui signifie aussi «lancer» (des pierres, une arme à quelqu'un) avec *sillem* «se tourner» et «diriger ses attaques contre quelqu'un» (M. La Piana). A confronter, pour le sens, gr. φέρω face à φέρω «porter», l'all. *sich gegen jemand wenden*, le frç. *se diriger vers quelqu'un*, etc.

surmë (i) «gris foncé». Plutôt que d'un mot hérité, apparenté à *i thjermë* «cendré» et, en dehors de l'albanais au lit. *širmas širvas* «gris», brun» (N. Jokl), il s'agit d'un emprunt régional au serbo-cr. *sur* «gris, cendré».

susàk m. «calebasse». Du turc *susak* «sec, non arrosé».

sutë f. «biche» Etant donnés *sutë lakne* «chou pommé» et *sutaku i kresë* «de crâne», le sens premier de ce mot résulte être «tête», cfr. à cet égard l'all *Kopfhohl* (*Kopf*), le lat. *Brassica oleracea capitata*, etc. Dès lors, *sutë* coïncide avec *shutë* fém. «sans cornes», mot qui désigne aussi la biche. L'actuel *sutë* d'un antérieur **çut-*. Cette ancienne phase se maintient dans le roum. *ciut* «sans cornes», *ciută* «biche», à coté de *șut* sans cornes», mot qui se relève ainsi d'origine albanaise.

sy m. «oeil». Ce mot d'origine discutée, pour des raisons d'ordre phonétique n'est comparable ni au sl. *sinjti* «reluire, briller» got. *skeinan* all. *scheinen* (G. Meyer, Brugmann, H. Hirt), ni au lit. *akis* sl. *oči*, etc. (Pedersen et beaucoup d'autres savants), ni au got. *hveits* «blanc» lit. *szvidus* «resplendissant» anc. indien *çvindate* «resplendit» (O. Wiedermann). Reflétant un **syn*, d'une forme de base **sūn-*, ce mot se rapproche de la désignation du soleil en germanique, got. *sunno* et *sunnin*, anc. haut all. *sunna*, comparé jusqu'à présent à l'iranien, av. *xvang* «le soleil» *xvanvant* «soleillé». A confronter pour l'évolution sémantique l'anc. irl. *súil* «oeil»; lat. *sol*, gr. ἥλιος, etc. La phonétique du mot (*s* primitif reflété par *s* devant *u*) n'est pas sans parallèles. Dans ces circonstances s'impose une révision des théories relatives au traitement de l'*s* indo-européen dans la langue albanaise.

synôj «viser». Verbe dénommatif de *sy* «oeil». Aussi *me përsynue* même sens. Cfr., pour la forme et le sens, roum. *ochiesc* «viser» (*ochiu* «oeil»). Un autre postverbal de *sy*, *përsýsh* «ensorceler en regardant», est comparable sous cet aspect au néo-gr. μαάιτζω même sens.

sysk syk, fém. *syskë sykë* «du bétail ayant un cercle noir autour des yeux et des taches tout aussi noires au visage». Des élargissements de *sy* «oeil» en *-sk* *-et* *-k*, dont le premier se retrouve p. ex. aussi dans *dele briskë* «brebis cornue». Le même principe de dénomination dans le roum. *oacheș* «brunet» (*ochiu*) et le néo-gr. ματύολλις ματύολλου: μάτι.

Dès lors, le roum. *oachin oacăn oacăr* s'explique tout aussi par *ochiu*, et la construction d'une forme de base latine (**obaquilus*) devient insoutenable.